



SIGMA

Mbështetje për përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit
Iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Europian, financuar kryesisht nga BE

**POLITIKAT DHE PRAKTIKAT E KONFLIKTIT TË
INTERESAVE NË NËNTË VENDE ANËTARE TË BE:NJË
PËRMBLEDHJE KRAHASUESE**

DOKUMENTI I SIGMA-S NR. 36

Dokumenti i përgatitur për Sigma-n nga:

Prof. Manuel Villoria-Mendieta
Universiteti Rey Juan Carlos, Madrid, Spanjë

Dhjetor 2005

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Pikëpamjet e paraqitura në të nuk përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin SIGMA.

PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore - është një nismë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Bashkimit Europian, e financuar kryesisht nga Bashkimi Europian.

Duke punuar në partneritet me vendet përfituese, Sigma mbështet qeverisjen e mirë përmes:

- vlerësimin të përparimit të reformave dhe identifikimit të përparësive bazuar në të dhëna bazë që pasqyrojnë praktikën e mirë europiane dhe legjislacionin ekzistues të BE-së (the *acquis communautaire*);
- dhënies së ndihmës për vendimmarrësit dhe administratat në ndërtimin e institucioneve dhe hartimin e kuadrit ligjor e krijimin e procedurave për realizimin e standardeve dhe praktikën e mirë;
- lehtësimin të ndihmës nga BE dhe donatorë të tjerë brenda dhe jashtë Europës duke ndihmuar për hartimin e projekteve, garantimin e parakushteve dhe mbështetjen për zbatimin.

Në vitin 2006, Sigma punon me vendet e mëposhtme partnere:

- Shtetet e reja anëtare të BE-së – Qipro, Republika Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Malta, Poloni, Sllovaki dhe Slloveni.
- Vendet kandidatë të BE-së – Bullgari, Kroaci, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumani dhe Turqi.
- Vendet e Ballkanit Perëndimor - Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë (Shteti, Federata e B dhe H, dhe Republika Serbska), Serbi, Mali i Zi, dhe Kosovë (e qeverisur që në qershor 1999 nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë – UNMIK).
- Ukrainë (vlerësimi i qeverisjes i financuar nga Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar).

Programi SIGMA mbështet përpjekjet për reformë të vendeve partnere në fushat si më poshtë:

- Kuadri ligjor dhe administrativ, shërbimi civil dhe drejtësia, sistemet publike të integritetit;
- Kontrolli financiar dhe auditimi i jashtëm, përfshirë menaxhimin e fondeve të BE-së, sistemet e kontrollit të brendshëm financiar publik, dhe institucionet e larta të auditimit;
- Menaxhimi i shpenzimeve publike, sistemet e buxhetit dhe të thesarit;
- Sistemet e prokurimeve publike;
- politikëbërje dhe koordinim; rregullim më i mirë.

Për më shumë informacion mbi Programin SIGMA, shihni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

Të drejtat e autorit: OECD

Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Conflict of Interest Policies and Practices in Nine EU Member States: A comparative Review*.

OECD autorizon përdorimin e këtij materiali pa pagesë, për qëllime jofitimprurëse. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime fitimprurëse të këtij materiali ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike rights@oecd.org.

PARATHËNIE

Ky dokument u përgatit nga Sigma me kërkesën e Ministrisë së Brendshme të Republikës Çeke për të shërbyer si një dokument pune themelor krahasues për përgatitjen e një politike dhe rregulloreje të re mbi konfliktin e interesave në sektorin publik çek. Duke marrë në konsideratë orientimin e tij të përgjithshëm, dokumenti mund të jetë i dobishëm edhe për vende të tjera që kryejnë reforma specifike në fushën e konfliktit të interesit dhe reforma të përgjithshme në fushën e politikave dhe instrumenteve antikorrupsion.

Ky dokument ofron të dhëna përshkruese dhe një përmbledhje analitike të qasjeve për menaxhimin e konfliktit të interesit në sektorin publik në nëntë vende evropiane – gjashtë vende anëtare “të vjetra” të BE (Francë, Gjermani, Itali, Portugali, Spanjë dhe Mbretëri e Bashkuar) dhe tre vende “të reja” anëtare të BE (Hungari, Letoni dhe Poloni). Po ashtu, ky dokument jep disa përfundime që ia vlen të merren në konsideratë kur reformohen politikat dhe instrumentet për të përmirësuar rregulloret dhe praktikatat mbi konfliktin e interesit.

Rekomandimi i OECD i vitit 2003 mbi Udhëzuesin për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik shërbeu si bazë për hartimin e kuadrit konceptual dhe pyetësorin e sondazhit. Një version më i hershëm i pyetësorit u testua në vendet e Europës Juglindore në fillim të vitit 2005. Udhëzuesi përmbante gjithashtu standarde të mira praktike për masat për parandalimin e konfliktit të interesave. Informacion i mëtejshëm gjendet në faqen e internetit të Gov: www.oecd.org/gov/ethics.

Nën drejtimin e Sigma, Prof. Manuel Villoria në Madrid përgatiti këtë dokument mbi bazën e informacionit të hartuar nga vendet e sipërpërmendura. Ekspertët e përzgjedhur në këto vende dhanë kontributin e tyre duke ofruar informacion në përgjigje të një pyetësori të standardizuar. Autori dhe Sigma dëshirojnë t'u shprehin mirënjohjen e tyre këtyre kontribuuesve: Z. Antoine Godbert, Drejtoria e Përgjithshme e Administratës Publike dhe Shërbimit Civil në Francë; Dr. Bernhard Schloer nga Gjermania; Prof. Bernardo Giorgio Mattarella nga Universiteti i Sienës, Itali; Z. Julio Nabais, Sekretar i Përgjithshëm i Parlamentit në Portugali; Prof. Manuel Villoria nga Universiteti Rey Juan Carlos, Madrid, Spanjë; Z. Michael Carpenter, këshilltar ligjor, Dhoma e Komuneve në MB; Dr. Zoltan Hazafi, zëvendës drejtor i përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme, Hungari; Z. Aleksejs Snitnikovs nga Zyra e Parandalimit dhe Luftës kundër Korrupsionit në Letoni; dhe Prof. Patrycja Joanna Suwaj nga Universiteti i Bialystok, Poloni. Falënderime të veçanta shkojnë edhe për Janos Bertok nga OECD/Gov për mendimet dhe këshillat e tij për përgatitjen e këtij dokumenti.

Secili prej nëntë raporteve në nivel kombëtar përmban informacion – deri në shtator 2005 – mbi kuadrin ligjor, mjetet, institucionet, procedurat dhe praktikatat menaxhuese që janë miratuar për të menaxhuar konfliktin e interesave në vendin përkatës. Çdo studim përmban gjithashtu informacion mbi sistemin e dënimit ligjor të parashikuar në rastet kur shkelen rregulloret dhe llojin e organit apo autoritetit të ngritur për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me rregulloret mbi konfliktin e interesit.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni me pjesëtarët e stafit Z. Francisco Cardona (francisco.cardona@oecd.org), Janos Bertok (janos.bertok@oecd.org) ose Znj. Françoise Drouillon (françoise.drouillon@oecd.org).

PASQYRA E LËNDËS

PROGRAMI SIGMA	2
PARATHËNIE.....	3
PASQYRA E LËNDËS.....	4
HYRJE	5
I. KUADRI KONCEPTUAL	6
Përkufizimi i konfliktit të interesit	6
Konflikti i interesit dhe korrupsioni.....	6
Demokracia dhe perceptimi i publikut mbi korrupsionin	6
Politikat dhe instrumentet antikorrupsion	9
II. TË PËRBASHKËTAT DHE TË VEÇANTAT NË NËNTË VENDET	11
A. Elementët e përbashkët	11
B. Elementet e veçantë.....	17
III. PËRMBLEDHJE E NËNTË RASTEVE	27
IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME MBI POLITIKAT	29
SHTOJCA 1	32

HYRJE

Dokumenti përmban katër pjesë dhe një shtojcë që jep një tabelë përmbledhëse të nëntë vendeve të shqyrtuara.

Pjesa e parë paraqet kuadrin konceptual dhe përkufizimet e konfliktit të interesit në sektorin publik, dhe përpiqet t'i vërë politikat mbi konfliktin e interesit brenda kuadrit të politikave më të gjera që synojnë parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Po ashtu, ajo tregon qëllimin e këtyre politikave dhe rëndësinë e tyre për një demokraci që funksionon mirë.

Pjesa e dytë shqyrton të përbashkëtat e strukturave, të mekanizmave dhe të metodave të përdorura për menaxhimin e konfliktit të interesit në nëntë vendet e përzgjedhura anëtare të BE. Ajo gjithashtu analizon ndryshimet e mëdha në kuadrin ligjor, mjetet e zbatimit, mekanizmat e vlerësimit dhe mjetet detyruese apo shtrënguese. Në këtë pjesë, dokumenti synon të tregojë qëllimin e politikave të ndryshme për hartimin dhe vendosjen e kufizimeve për aktivitete të ligjshme ekonomike, shoqërore dhe politike të zyrtarëve publikë, përfshirë politikanët (në lidhje me aktivitete ekonomike dhe transparencën) dhe punonjësit e shërbimit civil (në lidhje me aktivitetet ekonomike dhe pjesëmarrjen në parti politike).

Pjesa e tretë përmbledh rastet studimore të nëntë vendeve, duke identifikuar problemet dhe vështirësitë kryesore të hasura në çdo vend për hartimin dhe zbatimin e politikave të konfliktit të interesit. Ajo përfshin një vlerësim të avantazheve dhe disavantazheve të instrumenteve të ndryshëm ligjorë në lidhje me vlefshmërinë e tyre për parandalimin dhe menaxhimin e drejtë të situatave aktuale të konfliktit të interesave.

Së fundi, pjesa e katërt e dokumentit përqendrohet tek hartimi i disa përfundimeve që mund të lexohen si rekomandime duke ofruar alternativa të ndryshme për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe rregulloreve mbi konfliktin e interesit dhe luftën kundër korrupsionit.

I. KUADRI KONCEPTUAL

Përkufizimi i konfliktit të interesit

Ky dokument përdor kryesisht si referencë konceptuale përkufizimin e përgjithshëm të OECD mbi konfliktin e interesit. Përkufizimi është si më poshtë: “Konflikti i interesit përfshin një konflikt ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari publik në të cilin interesi privat i zyrtarit publik mund të ndikojë në mënyrë të padrejtë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij publike”¹.

Ne marrim në konsideratë – brenda konceptit të gjerë të konfliktit të interesave – jo vetëm situatën kur në fakt ka një konflikt të papranueshëm ndërmjet interesave të një zyrtari publik si një qytetar privat dhe detyrës së tij/saj si një zyrtar publik, por edhe ato situata kur ka një konflikt që duket si konflikt interesi ose një konflikt interesi të mundshëm.

Një konflikt që duket si konflikt interesi i referohet një situatë kur ka një interes personal që konsiderohet nga të tjerët në mënyrë të arsyeshme që ndikon tek detyrat e zyrtarit publik, edhe nëse në fakt nuk ka një ndikim të tillë ose mund të mos ketë një ndikim të tillë të padrejtë. Mundësia për dyshim mbi integritetin e zyrtarit dhe/ose integritetin e agjencisë ku zyrtari punon e bën të detyrueshme që të konsiderohet një konflikt interesi që duket si i tillë si një situatë që duhet të shmanget.

Konflikti i mundshëm i interesit mund të ekzistojë kur një zyrtar publik ka interesa private që mund të shkaktojnë që një konflikt interesi të lindë në një kohë të caktuar në të ardhmen. Një shembull është rasti i një zyrtari publik bashkëshortja e të cilit mund të emërohet në javët e ardhshme si drejtoreshë ekzekutive ose CEO e një kompanie që ka lidhje me një vendim të kohëve të fundit të marrë nga zyrtari, dhe zyrtari publik ka dijeni për emërimin e bashkëshortes. Prandaj, përkufizimi themelor i përdorur këtu supozon se një person i arsyeshëm, duke njohur të gjitha faktet përkatëse, do të arrinte në përfundimin se interesi privat i zyrtarit do të ndikonte në mënyrë të padrejtë në sjelljen ose vendimmarrjen e tij/saj.

Konflikti i interesit dhe korrupsioni

Duhet të kuptohet se konflikti i interesit nuk është i njëjtë me korrupsionin. Ndonjëherë ka konflikt interesi kur nuk ka korrupsion dhe e kundërta. Për shembull, një zyrtar publik i përfshirë në marrjen e një vendimi në të cilin ai/ajo ka një interes privat mund të veprojë drejt dhe në përputhje me ligjin, dhe si pasojë nuk ka korrupsion në këtë rast. Një zyrtar tjetër publik mund të marrë rryshfet (korrupsion) për marrjen e një vendimi që ai gjithsesi do ta merrte, pa përfshirjen e ndonjë konfliktit interesi në veprimin e tij/saj.

Megjithatë, është po ashtu e vërtetë se në pjesën më të madhe të rasteve korrupsioni shfaqet në ato raste kur një interes i mëparshëm privat ka ndikuar në kryerjen e padrejtë të detyrës së zyrtarit publik. Kjo është arsyeja pse do të ishte e mençur të mendohet parandalimi i konfliktit të interesave si pjesë e një politike më të gjerë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. E vendosur në këtë kontekst, politikat mbi konfliktin e interesit janë një instrument i rëndësishëm për ndërtimin e integritetit të sektorit publik dhe për mbrojtjen dhe nxitjen e demokracisë.

Demokracia dhe perceptimi i publikut mbi korrupsionin

Qëndrimet e publikut ndaj politikës, politikanëve, partive politike dhe parlamenteve duket se pasqyrojnë rritjen e rënies së besimit tek ta. Zhgënjimi me politikën dhe politikanët është një ndjenjë pothuajse universale. Në disa vende kjo tendencë e pakënaqësisë me politikën, e mungesës së besimit tek drejtuesit politikë dhe e besimit në rënie tek parlamenti po dobëson funksionimin e demokracisë dhe përmban një rrezik të caktuar për dështim të demokracisë. Në vende të tjera ky qëndrim është thjesht një shprehje e lodhjes me mënyrën tradicionale të politikës.

Një tezë themelore e këtij dokumenti është se korrupsioni në sektorin publik është një prej arsyeve më të rëndësishme pas kësaj prirjeje shqetësuese. Megjithatë, për të kuptuar këtë thënie është e rëndësishme të

¹ Rekomandimi i Këshillit mbi Udhëzime për Menaxhimin e Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik, shih tek <http://www.oecd.org/dataoecd/13/22/2957360.pdf>.

njihet se çfarë është korrupsioni. Nëse korrupsioni është vetëm rryshfet, atëherë korrupsioni nuk do të ishte shkak i pakënaqësisë në shumicën e vendeve evropiane, sepse dhënia rryshfet zyrtarëve publikë nuk është një praktikë e zakonshme në to. Por korrupsion nuk është vetëm rryshfeti. Korrupsioni është gjithashtu edhe kapja e politikave, abuzimi me pushtetin, financimi i paligjshëm i partive politike, blerja e votave, ofrimi i favoreve dhe trafik i influencës. Korrupsion nuk është vetëm abuzimi i paligjshëm me detyrën nga zyrtarët publikë për të përfituar interes privat të drejtpërdrejtë. Korrupsion është gjithashtu abuzimi joetik me detyrën. Interesi privat i përfshirë nuk është vetëm i drejtpërdrejtë por edhe i tërthortë, që do të thotë se mund të ketë lidhje jo vetëm me zyrtarin publik por edhe me partinë politike që e ka caktuar atë.

Mungesa e një kuadri të gjerë dhe e njohurive mbi shkaqet, pasojat dhe natyrën e korrupsionit tradicionalisht nënkuptojnë se studiuesit e shkencave sociale dhe ekspertët ligjorë kanë pasur prirjen të vlerësojnë korrupsionin në demokracitë perëndimore vetëm nën këndvështrimin e të drejtës penale. Për shembull, sipas raportit të vitit 2002 të Institutit të Shoqërisë së Hapur², mungesa e një kuadri të tillë të gjerë e gjithëpërfshirës në vendet e BE do të thotë që vlerësimi i Komisionit Evropian mbi korrupsionin në vendet që në atë kohë ishin vende kandidatë për në BE prirej të bëhej nisur nga një këndvështrim bazuar tek rryshfeti (“bribo-centric”). Përderisa shumica e demokracive perëndimore nuk kanë nivele të larta të korrupsionit penal, kur u analizua pakënaqësia për politikën në vendet më të zhvilluara korrupsioni nuk u konsiderua të jetë një variabël i rëndësishëm.

Korrupsioni është më shumë sesa rryshfeti. Korrupsioni është korrupsioni i politikave, që do të thotë të gjitha llojet e veprimeve ku aktorët politikë (përfshirë zyrtarët publikë) shkelin rregullat e lojës politike (demokratike) dhe vënë interesat e tyre private përpara çdo gjëje tjetër. Për shembull, rregullat e lojës politike (demokratike) parashikojnë se zyrtarët publikë nuk duhet të abuzojnë me detyrën e tyre për të pasur përfitime private në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë. Abuzim me detyrën nuk është vetëm kur shkelin ligjin, por edhe kur shkelin rregullat e etikës publike me qëllim rritjen e pushtetit apo pasurisë personale.

Duke marrë në konsideratë këto çështje, është e qartë se korrupsioni është një kërcënim i rëndësishëm për institucionet dhe proceset demokratike. Ai ka pasojat negative politike, ekonomike dhe shoqërore. Politikisht, ai ul cilësinë e demokracisë dhe performancës së qeverisë dhe krijon kapital social negativ. Kur korrupsioni është i lartë, nuk ka barazi politike, dhe trajtimi preferencial për më të korruptuarit është rregull në regjimet politike ku pushtetin e mbajnë rrjete të korruptuara. Në vende me korrupsion të lartë, politikanët dhe nëpunësit civilë të korruptuar janë të interesuar të mbajnë një administratë publike ineficiente, sepse ata në mënyrë të selektuar mund t’i ofrojnë kësaj administrate mbrojtje nga telashet si pasojë e ineficiencës. Korrupsioni kërkon besim ndërmjet aktorëve që marrin pjesë në shkëmbime të paligjshme; ky besim favorizon përhapjen e rrjeteve të dendura sociale, por këto rrjete janë sinonime me patronazhin, klientelën personale dhe rryshfetin. Korrupsioni politik ushqen dhe riprodhon këto rrjete.

Në këndvështrimin ekonomik, korrupsioni pengon zhvillimin dhe dekurajon investimet. Në pikëpamje sociale, ai nxit pabarazinë ekonomike dhe psikologjike dhe përhap besim me kusht dhe ekskluziv, vetëm tek disa institucione. Besimi vetëm tek disa institucione pengon zhvillimin e besimit të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës dhe besimi i përgjithshëm është themel për solidaritet shoqëror dhe politikëbërje të drejtë. Si përfundim, pakënaqësia e qytetarëve me funksionimin e qeverive dhe partive politike përkthehet me shpejtësi në rënien e nivelit të kënaqësisë me demokracinë, rënien e nivelit të besimit të përgjithshëm dhe rritjen e nivelit të popullaritetit të kandidatëve populistë dhe partive ekstremiste.

Në një sistem demokratik që funksionon mirë ka një parim themelor që është se politika duhet të identifikojë dhe të nxitë interesin e përgjithshëm duke respektuar njëkohësisht rregullat e paravendosura të lojës. Politikanët duhet ta mbajnë mend këtë parim. Nëpunësit civilë duhet gjithashtu të mbajnë parasysh këtë parim kur marrin pjesë në hartimin e politikave dhe kurdoherë që ata marrin vendime, përgatisin ose zbatojnë këto vendime dhe i vlerësojnë ato.

Mungesa e marrjes në konsideratë e këtij parimi është një prej shkaqeve të besimit të ulët tek institucionet kryesore demokratike dhe një prej arsyeve më të rëndësishme pse shumica e qytetarëve në disa vende nuk janë të kënaqur me funksionimin e demokracive të tyre. Siç tregohet në Tabelën 1, besimi tek Parlamenti

2 Institutit i Shoqërisë së Hapur /Programi i monitorimit të pranimit në BE: “Monitorimi i procesit të pranimit në BE: Korrupsioni dhe Politika Antikorrupsion”. Budapest, 2002.

është i ulët në të gjitha vendet evropiane të studiuara. Megjithatë, është po ashtu e vërtetë se rezultatet e anketimeve nuk janë të njëjta për të gjitha vendet. Është e qartë se kur niveli i korrupsionit – i kuptuar si rryshfet – është gjithashtu i lartë në një vend, rezultatet e anketimit për atë vend janë më të këqija sesa për vendet e tjera që kanë traditë korrupsion të ulët. Këto rezultate janë më të këqija jo vetëm për pyetjen mbi besimin tek parlamenti, por edhe për pyetjen mbi nivelin e kënaqësisë me funksionimin e demokracisë (shih Tabelën 1).

Tabela 1. Besimi tek Parlamenti, kënaqësia me funksionimin e demokracisë dhe pikët në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) të vitit 2005 në nëntë vendet në analizë krahasuese dhe në Republikën Çeke.

Vendi	I madh, besim i madh tek parlamenti (përqindje)	Shumë të kënaqur, disi të kënaqur me mënyrën si funksionon demokracia në vendin tonë (Përqindje)	CPI 2005
Vendet “e reja” anëtare të BE			
Republika Çeke	12,0	36,6	4,3
Hungari	32,6	31,6	5,0
Letoni	26,3	28,2	4,2
Poloni	30,1	40,6	3,4
Vendet “e vjetra” anëtare të BE			
Francë	38,8	45,5	7,5
Gjermani	34,2	72,8	8,2
Itali	33,2	34,6	5,0
Portugali	43,7	72,3	6,5
Spanjë	45,0	63,2	7,0
Mbretëri e Bashkuar	34,1	44,4	8,6

Burimi: Sondazhi i Vlerave Botërore (World Values Survey), 2000 dhe CPI 2005 (TI).

Në përfundim, megjithëse konflikti i interesave dhe korrupsioni janë koncepte të ndryshme, duket e përshtatshme se politikat që trajtojnë konfliktin e interesave të jenë pjesë e një strategjie apo politike më të gjerë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, kjo nuk është praktika në pjesën më të madhe të vendeve anëtare të BE para vitit 2004 të analizuara në këtë dokument – përveçse në MB dhe deri

në njëfarë pike në Gjermani (shih më poshtë), ndërsa është një praktikë fare e zakonshme në vendet që janë bërë anëtare të BE pas vitit 2004. Kjo praktikë mund të jetë ndikuar nga institucionet e BE, veçanërisht Komisioni, gjatë procesit të negociatave për pranim, dhe kjo ngre çështjen nëse kërkesa për hartimin e një strategjie të gjerë antikorrupsion është më shumë një ideal teknokratik sesa një realitet politik në demokracitë e konsoliduara.

Cilido qoftë rasti, politikat dhe strategjitë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit janë shumë të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së një demokracie, dhe edhe për mbrojtjen e demokracisë kundër populizmit, apatisë dhe zhgënjimit. Si pasojë, politikat mbi konfliktin e interesave janë gjithashtu të rëndësishme për përmirësimin dhe konsolidimin e demokracive tona evropiane.

Politikat dhe instrumentet antikorrupsion

Politikat që kanë për qëllim parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit përfshijnë instrumente dhe strategji shumë të ndryshme që mund të grupohen në katër kategori të mëdha: struktura, parandalimi, zbulimi dhe hetimi (investigimi), dhe ndëshkimi.

1. *Kuadri strukturor*, që përfshin jo vetëm angazhimin politik dhe drejtimin etik por edhe strategjitë e politikave të hartuara për të shmangur pabarazitë e dukshme, për të krijuar besimin e përgjithshëm e gjithëpërfshirës, për të përhapur kapital social të mirë dhe për të ndërtuar një demokraci me cilësi të lartë. Një kuadër i fortë strukturor kërkon ekzistencën e kushteve të caktuara kushtetuese sepse një demokraci me cilësi të lartë përfaqëson parimet përkatëse të kontrollit popullor dhe të barazisë politike³.

Këto parime kanë katër dimensionet:

- Zgjedhje të lira dhe të ndershme;
 - Qeveri të hapur, transparente dhe të përgjegjshme;
 - Të drejta dhe liri të garantuara civile dhe politike; dhe
 - Një shoqëri demokratike që përfshin median e lirë që arrin tek grupe të ndryshme shoqërore, përgjegjshmërinë publike të kompanive të fuqishme private dhe një kulturë politike e sistem arsimor demokratik.
2. *Instrumentet e parandalimit*, që përfshijnë një kuadër ligjor efektiv, një kod etike të zbatueshëm, një sistem të përgjegjshmërisë, një shërbim civil bazuar mbi karrierën dhe meritat dhe mekanizmat e socializimit profesional veçanërisht në etikën dhe vlerat demokratike.
3. *Instrumentet e zbulimit dhe hetimit*, që përfshijnë një organ koordinues që vepron si mbikëqyrës, sinjalizimet përmes linjave telefonike dhe programet për mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe një rrjet efektiv të prokurorëve publikë të specializuar si edhe gjyqtarë, inspektorë e kontrollorë të përgjithshëm të kualifikuar si duhet.
4. *Instrumentet e ndëshkimit*, me ligje penale, sisteme disiplinore, procedura për përgjegjësinë ekonomike dhe ndëshkime administrative.

Politikat dhe instrumentet e konfliktit të interesit

Ku vendosen politikat mbi konfliktin e interesave në kuadrin e gjerë të politikave anti-korrupsion? Sigurisht ato janë pjesë e të katër grupeve. Ato janë pjesë e kuadrit strukturor sepse këto politika ndihmojnë sistemin demokratik të krijojë besim të përgjithshëm dhe të hapë qeverinë ndaj kontrollit. Ato janë pjesë e strategjisë parandaluese sepse rregulloret mbi konfliktin e interesit, kodet e etikës, ligjet mbi papajtueshmërinë dhe instrumente të tjera – si rregullat mbi heqjen dorë dhe tërheqjen rutinë – përbëjnë një qasje shumë efektive në parandalimin e korrupsionit. Politikat e konfliktit të interesit janë gjithashtu pjesë e zbulimit dhe hetimit të

³ Beetham, David (1994), *Defining and Measuring Democracy*, Sage, London.

korrupsionit sepse instrumente të caktuara të këtyre politikave – si deklarimi i të ardhurave apo deklarimi i pasurisë familjare – mund të ndihmojnë shumë për zbulimin e praktikave korruptive. Së fundi, ato janë pjesë e instrumenteve ndëshkuese sepse në disa vende konflikti i interesave konsiderohet krim dhe vende të tjera kanë parashikuar ndëshkime të ndryshme për shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve mbi konfliktin e interesave.

Instrumentet më të rëndësishëm për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave janë:

- Kufizime për dypunësimin;
- Deklarimi i të ardhurave personale;
- Deklarimi i të ardhurave familjare;
- Deklarimi i pasurisë personale;
- Deklarimi i pasurisë familjare;
- Deklarimi i dhuratave;
- Siguria dhe kontrolli për marrjen e informacionit të brendshëm;
- Deklarimi i interesave private që kanë lidhje me menaxhimin e kontratave;
- Deklarimi i interesave private që kanë lidhje me vendimmarrjen;
- Deklarimi i interesave private që kanë lidhje me pjesëmarrjen në përgatitjen apo ofrimin e këshillave për politikën;
- Bërja publike e deklaratave të të ardhurave dhe të pasurisë;
- Kufizime dhe kontrolli i punësimit ose i aktivitetit me OJQ pas largimit nga detyra publike;
- Kufizime dhe kontrolli i dhuratave dhe formave të tjera të përfitimeve;
- Kufizime dhe kontrolli i punësimit të dytë të njëkohshëm (për shembull në një OJQ, parti politike ose korporatë në pronësi të shtetit);
- Dorëheqja dhe tërheqja rutinë e zyrtarëve publikë nga detyra publike kur pjesëmarrja në një mbledhje apo marrja e një vendimi të veçantë do t'i vendoste ata në një situatë konflikti;
- Kufizime personale dhe familjare mbi titujt e pronësisë të kompanive private;
- Zhveshja nga pronësia ose përmes shitjes së interesave të biznesit apo investimeve, ose përmes arritjes së një marrëveshjeje menaxhimi besimi apo qorre.

II. TË PËRBASHKËTAT DHE TË VEÇANTAT NË NËNTË VENDET

A. Elementët e përbashkët

Ky dokument ofron një pamje të përgjithshme të elementëve të përbashkët të programeve të ndryshme kombëtare që trajtojnë konfliktin e interesave. Për këtë qëllim, do të ndjekim listën e çështjeve që kanë lidhje me politikat e konfliktit të interesit dhe do të analizojmë se si ato janë trajtuar në vendet në analizë (shih gjithashtu tabelën sinoptike tek Shtojca).

1. Pjesë e një politike apo strategjie më të gjerë? Të gjitha vendet “e reja” anëtare të BE të studiuara në këtë raport kanë miratuar zyrtarisht një strategji të gjerë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe programet e tyre mbi konfliktin e interesit janë pjesë e këtyre strategjive të gjera. Megjithatë, Shtetet Anëtare “të vjetra” të BE nuk i kanë këto strategji të gjera – vetëm në Gjermani ka një marrëveshje federale kundër korrupsionit. Si rezultat, politikat mbi konfliktin e interesave nuk përbëjnë pjesë të një politike më të gjerë në këto vende. Megjithatë, MB është një përjashtim, sepse programet mbi konfliktin e interesave janë pjesë e një politike të gjerë të “standardeve etike në sektorin publik”. Ato nuk janë pjesë e një strategjie të gjerë kundër korrupsionit por pjesë e një strategjie të gjerë për të garantuar dhe përmirësuar standardet etike në sektorin publik.

2. Qasje parandaluese? Të gjitha vendet “e reja” të BE të analizuara në këtë raport kanë qasje parandaluese dhe kuruese, megjithëse në rastin e Hungarisë qasja është kryesisht parandaluese. Hungaria nuk ka ndonjë ndëshkim penal për shkeljet e rregullave të konfliktit të interesit, por Letonia dhe Polonia kanë ndëshkime të tilla. Franca gjithashtu i përdor të dyja qasjet dhe ka përcaktuar edhe një vepër penale të caktuar për konfliktin e interesave duke iu referuar si “kërkim i paligjshëm i interesit”. Pesë vendet e tjera “të vjetra” të BE përdorin qasjen parandaluese.

3. Masat parandaluese

- Kufizime për punësimin shtesë: Në të gjitha vendet e studiuara, zyrtarët publikë kanë kufizime për sa i përket punës së dytë. Të emëruarit politikë, përfshirë anëtarët e qeverisë, nëpunësit civilë dhe gjyqtarët e kanë këtë lloj kufizimi në të gjitha vendet, por Franca, Gjermania, Polonia dhe Spanja janë më strikte sesa të tjerat. Të gjitha vendet kanë kufizime për punësimin shtesë të deputetëve të parlamentit në sektorin publik, por vetëm Spanja e quan të papajtueshëm detyrën e deputetit të parlamentit me punën e dytë në sektorin privat. Zyrtarët e zgjedhur vendorë mund të jenë deputetë të parlamentit kombëtar në Francë dhe Hungari. Në të gjitha vendet ka kufizime për punësimin publik apo privat kur të zgjedhurit vendorë janë të punësuar me kohë të plotë dhe marrin edhe rrogë për pozicionet për të cilat janë zgjedhur.
- Deklarimi i të ardhurave personale: Ky lloj deklarimi nuk është i domosdoshëm në Francë, Gjermani dhe MB, por në dy vendet e fundit deputetët e parlamentit duhet të deklarojnë disa lloj pagesash të caktuara kur shuma është e madhe. Në Hungari dhe Itali, vetëm deputetët e parlamentit duhet të deklarojnë të ardhurat (në Itali të emëruarit politikë tashmë duhet të deklarojnë disa të ardhura të caktuara), ndërsa në Poloni vetëm të zgjedhurit vendorë dhe të emëruarit në poste politike duhet të deklarojnë të ardhurat e tyre. Në Spanjë, të zgjedhurit vendorë dhe të emëruarit në poste politike duhet të deklarojnë të ardhurat e tyre dhe deputetët e parlamentit duhet të deklarojnë veprimtaritë e paguara. Në Letoni, zyrtarët duhet të deklarojnë të ardhurat e tyre, jo vetëm të emëruarit politikë dhe zyrtarët e zgjedhur por edhe nëpunësit civilë.
- Deklarimi i të ardhurave familjare. Vetëm në Poloni janë të detyruar bashkëshorti/bashkëshortja e të zgjedhurve vendorë dhe të të emëruarve politikë të deklarojnë të ardhurat e tyre. Në Spanjë, ky deklarim është vullnetar për bashkëshortët e të emëruarve politikë. Në të gjitha vendet e tjera ky deklarim nuk është i detyrueshëm.
- Deklarimi i pasurisë personale: Në Gjermani dhe MB, nuk është i detyrueshëm deklarimi i pasurisë, megjithëse deputetët e parlamentit britanik duhet të deklarojnë pasurinë nëse ajo ka një vlerë më të madhe se 59,000 pounds sterling. Në Gjermani, nëpunësit civilë përpara se të emërohen duhet të bëjnë

një deklaram zyrtar duke pranuar se ata nuk kanë borxhe të mëdha. Në të gjitha vendet “e vjetra” të BE të studiuara, nëpunësit e shërbimit civil nuk e kanë detyrim të deklarojnë pasuritë, por në tre vendet “e reja” anëtare të BE ata janë të detyruar ta bëjnë këtë deklaram (në Hungari kjo zbatohet vetëm për drejtuesit e lartë). Anëtarët e qeverisë dhe të emëruarit politikë, deputetët e parlamentit dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë duhet t’i deklarojnë pasuritë në të gjitha vendet përveç Gjermanisë dhe MB.

- *Deklarimi i pasurisë familjare:* Në Poloni, bashkëshortet e zyrtarëve të zgjedhur vendorë dhe të të emëruarve politikë duhet gjithashtu të deklarojnë pasurinë e tyre. Në Hungari, të gjithë pjesëtarët e familjes që jetojnë me një të emëruar politik apo me një zyrtar të lartë duhet gjithashtu të deklarojnë pasurinë e tyre. Në të gjitha vendet e tjera ky deklaram nuk është i detyrueshëm.
- *Deklarimi i dhuratave:* Në Letoni, deklarami i dhuratave është i detyrueshëm për të gjithë zyrtarët publikë (përfshirë zyrtarët e zgjedhur dhe deputetët e parlamentit). Në Poloni, kjo aplikohet vetëm për të zgjedhurit vendorë dhe të emëruarit politikë dhe në Hungari vetëm për deputetët e parlamentit. Në Gjermani, Spanjë dhe MB është e detyrueshme për të emëruarit politikë dhe anëtarët e qeverisë. Deputetët e Parlamentit britanik duhet të deklarojnë çdo dhuratë që ka një vlerë më të madhe se 1% të rrogës së tyre. Deputetët e parlamentit gjerman duhet ta bëjnë të ditur këtë informacion nëse dhurata vlen më shumë se 5000 Euro. Në Francë, deputetët e parlamentit duhet të deklarojnë çdo dhuratë pavarësisht vlerës së tyre.
- *Siguria dhe kontrolli për marrjen e informacionit të brendshëm:* Në të gjitha vendet, nëpunësit civilë duhet të mbajnë sekret çdo informacion konfidencial, por në Francë, Hungari, Poloni dhe Spanjë ka rregulla dhe ndëshkime që e theksojnë qartë këtë detyrim. Deputetët e parlamentit në Hungari dhe Spanjë kanë detyrimin për të ruajtur sekretin.
- *Deklarimi i interesave private që kanë lidhje me menaxhimin e kontratave:* Një deklaram zyrtar nga të emëruarit politikë i interesave të tilla private kërkohet në vende të tilla si Portugali (përfshirë informacionin për tre vitet përpara emërimit) dhe Spanjë (dy vjet). Në Gjermani dhe Spanjë ky deklaram është i detyrueshëm edhe për zyrtarët e zgjedhur vendorë. Në MB, zyrtarët publikë, përfshirë zyrtarët e zgjedhur vendorë duhet të bëjnë një deklaram zyrtar të interesave⁴ çdo herë që ka një interes

4 Deputetët në MB janë të detyruar të plotësojnë një formular që përmban dhjetë kategori të interesave të detyrueshme për t’u deklaruar, si më poshtë:

- 1) *Drejtimi* – çdo drejtim i kompanive, publike ose private, me shpërblim vlera e të cilit është më e lartë se 1% e rrogës aktuale si deputet (d.m.th. £590 në 1 prill 2005);
- 2) *Punë, detyrë, profesion i paguar* – çdo punë, detyrë, zanat ose profesion që shpërblehet me më shumë se 1% të rrogës së deputetit ose në të cilën deputeti ka një interes monetar; (Kjo kategori i kërkon deputetit të Parlamentit të bëjë të njohur anëtarësinë e tij në Lloyds, së bashku me bërjen publike të kategorisë së sigurimeve që nënshkruan deputeti.)
- 3) *Klientë* – çdo punë e paguar e regjistruar tek pika (1) ose (2) më sipër që kërkon ofrimin e shërbimeve për klientët që varen kryesisht tek pozicioni i anëtarit si deputet parlamentari, së bashku me bërjen transparente të emrave të klientëve dhe natyrës së biznesit të tyre; (Kjo kategori kërkon të përforcojë ndalimin, e zgjidhur nga Dhoma (the House) në 6 nëntor 1995, dhe është kundër lobimit për shpërblim ose marrje në konsideratë. Efekti i rregullit është që deputeti i parlamentit nuk duhet të iniciojë ose të marrë pjesë në punimet e Dhomës (the House) ose të një komisioni që synon t’i japë përfitimet ekskluzivisht tek një person apo organ i caktuar nga i cili deputeti merr pagesë. Shënimet në formular shpjegojnë se shërbimet përkatëse përfshijnë veprime të lidhura me procedurë parlamentare ose shërbime të tjera që lidhen me anëtarësinë në parlament, si financimi i takimeve apo funksioneve në ndërtesa parlamentare apo ofrimi i këshillave mbi çështje parlamentare ose publike.)
- 4) *Sponsorizimet* – çdo dhurim më i lartë se £1000 bërë tek zona e deputetit në 12 muajt e fundit dhe që lidhet në mënyrë specifike me kandidimin ose anëtarësinë e deputetit në parlament, ose çdo formë tjetër sponsorizimi apo përkrahje financiare apo materiale për deputetin që e kapërcen vlerën prej £1000 në vit; (Kjo kategori përfshin çdo burim mbështetjeje nga i cili deputeti i parlamentit merr përfitime financiare apo materiale, dhe do të përfshinte edhe ofrimin e akomodimit pa pagesë apo të subvencionuar ose ofrimin e shërbimeve nga një asistent ose pa pagesë ose me një tarifë të subvencionuar.)
- 5) *Dhuratat, përfitimet, mikëpritja* – çdo dhuratë, përfitim ose mikëpritje e marrë nga deputeti ose bashkëshortja ose partneri që ka vlerë më të lartë se 1% të rrogës së deputetit dhe që lidhet në ndonjë mënyrë me anëtarësinë në Dhomë (House); (Kjo kategori e gjerë përfshin çdo mikëpritje, shërbime ose lehtësira të siguruar me një kosto që është nën çmimin normal që paguan publiku. Dhurata ose përfitimi duhet të regjistrohet nëse vlera e grumbulluar nga një burim është më e lartë se kufiri prej 1%. Nuk ka nevojë të regjistrohen përfitimet që u jepen të gjithë deputetëve të parlamentit, ose të gjithë deputetëve brenda së njëjtës fushë, mikëpritja qeveritare, dhe kostot e arësyeshme të udhëtimit dhe dietat për ndjekjen e konferencave ose vizitat në terren.)
- 6) *Vizitat jashtë vendit* – çdo vizitë jashtë vendit nga deputeti ose bashkëshorti/bashkëshortja ose partneri gjatë 12 muajve të mëparshëm që lidhen me ose dalin si rezultat i anëtarësisë në Dhomë (the House) kur kostoja e ka kaluar 1% të rrogës së deputetit dhe nuk është përballuar plotësisht nga deputeti ose fondet

që nga të tjerët mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme se ushtron ndikim në kryerjen e detyrës së zyrtarit. Në deklaratën e tyre, zyrtarët publikë britanikë duhet të përfshijnë edhe interesat e pjesëtarëve të familjes dhe interesat e personave shumë të afërt me ta. Në Francë, Hungari, Itali, Letoni dhe Poloni nuk kërkohet ky deklaram zyrtar, por nëse ka një konflikt interesi specifik atëherë është e detyrueshme të deklarohet interesi privat i përfshirë në procedurë dhe të kërkohet leje për të hequr dorë.

- *Deklarimi i interesave private që kanë lidhje me vendimmarrjen apo votimin:* Një deklaram zyrtar i një interesi të tillë privat kërkohet në vende të tilla si Portugali (përfshirë informacionin mbi tre vitet përpara emërimit) dhe Spanjë (dy vjet) për të emëruarit politikë dhe deputetët e parlamentit, dhe në Spanjë edhe për zyrtarët e zgjedhur vendorë (në Portugali, për zyrtarët e zgjedhur vendorë deklarimi është vullnetar). Në Gjermani, ky deklaram është i detyrueshëm vetëm për zyrtarët e zgjedhur vendorë. Në MB zyrtarët publikë, përfshirë deputetët e parlamentit dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë, duhet të bëjnë një deklaram zyrtar të interesave çdo herë që ka një interes që nga të tjerët mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme se ka ndikim në kryerjen e detyrës së zyrtarit. Në deklaratën e tyre, zyrtarët publikë britanikë duhet të përfshijnë edhe interesat e pjesëtarëve të familjes dhe interesat e personave shumë të afërm. Në Francë, Itali, Letoni dhe Poloni nuk kërkohet ky deklaram zyrtar, por nëse ka një konflikt interesi specifik atëherë është e detyrueshme të deklarohet interesi privat i përfshirë në procedurë dhe të kërkohet leje për të hequr dorë.
- *Deklarimi i interesave private që kanë lidhje me pjesëmarrjen në përgatitjen apo ofrimin e këshillave për politikë:* Një deklaram zyrtar i interesave të tilla private është i detyrueshëm për të emëruarit politikë në vende si Portugalia (përfshirë informacionin mbi të tre vitet përpara emërimit) dhe Spanjë (dy vjet). Në Spanjë, ky deklaram është i detyrueshëm edhe për të zgjedhurit vendorë. Në Gjermani ky deklaram është i detyrueshëm vetëm për zyrtarët e zgjedhur vendorë. Në MB, zyrtarët publikë përfshirë të zgjedhurit vendorë duhet të bëjnë një deklaram zyrtar të interesave çdo herë që ka një interes që nga të tjerët mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme se ka ndikim në kryerjen e detyrës së zyrtarit. Në deklaratën e tyre, zyrtarët publikë britanikë duhet të përfshijnë interesat e pjesëtarëve të familjes dhe interesat e personave shumë të afërt me ta. Në Francë, Hungari, Itali, Letoni dhe Poloni nuk kërkohet ky deklaram zyrtar, por nëse ka një konflikt interesi specifik atëherë është e detyrueshme të deklarohet interesi privat i përfshirë në procedurë dhe të kërkohet leje për të hequr dorë.
- *Bërja publike e deklaratave të interesave, të të ardhurave dhe të aseteve.* Në Francë dhe Hungari nuk ka dispozita mbi bërjen publike të deklaratave, ndërsa në Poloni publikimi i deklaratave është i detyrueshëm vetëm për të zgjedhurit vendorë, dhe në Itali e Gjermani vetëm për deputetët e parlamentit. Në MB, të emëruarit në poste politike duhet të deklarojnë dhuratat dhe ky deklaram bëhet publik. Po ashtu, edhe deklaratat e interesave të deputetëve të parlamentit britanik bëhen publike. Në Spanjë, deklaratat e interesave të deputetëve dhe të zyrtarëve vendorë të zgjedhur bëhen publike vetëm me kërkesën e një personi apo personave të interesuar, por, sipas një projekt-ligji të ri, do të bëhen publike edhe deklaratat e aseteve të anëtarëve të qeverisë dhe të sekretarëve të shtetit. Në Portugali,

publike të MB; (Përfshihen vizitat e kryera nga ose në emër të Dhomës së Komuneve (the House of Commons) ose të komisioneve të saj apo të organizmave ndërparlamentare, të tillë si Këshilli i Europës.)

- 7) *Përfitime dhe dhurata nga jashtë vendit* – çdo dhuratë apo përfitim që e kalon vlerën 1% të rrogës së deputetit dhe i marrë në 12 muajt paraardhës nga anëtar, bashkëshorti, partneri nga ose në emër të ndonjë qeverie, organizate apo personi të huaj dhe që lidhet në ndonjë mënyrë me anëtarësinë në Dhomë; (Formulari kërkon që të bëhet publike natyra e përfitimit dhe burimi i tij.)
- 8) *Toka dhe prona* – çdo tokë dhe pronë (tjetër përveçse një shtëpi banimi e deputetit, bashkëshortit/es apo partnerit) që ka një vlerë më të lartë se £59,000, ose çdo e ardhur nga qiraja që është më e lartë se 10% e rrogës aktuale në parlament (d.m.th. £5,900 në 2005); (Deputetit të parlamentit i kërkohet të tregojë natyrën e të gjithë pronës në fjalë duke dhënë vendndodhjen e saj, por nuk duhet të regjistrohet sasia e të ardhurave nga qiraja.)
- 9) *Aksione* – çdo aksion më i lartë se 15% e kapitalit të përbashkët të një kompanie, ose çdo aksion prej 15% apo më pak kur vlera është më e lartë se rroga aktuale e deputetit; (Aksionet e mbajtura nga bashkëshorti/ja, ose partneri i deputetit nuk ka nevojë të regjistrohen.)
- 10) *Të ndryshme* – çdo interes tjetër që mendon deputeti duhet të bëhet publike. (Formulari këshillon se nuk është e detyrueshme të regjistrohen interesat që nuk shpërblehen, por këto interesa mund të regjistrohen nëse deputeti i parlamentit mendon se ato mund të konsiderohen nga të tjerët të ushtrjnë ndikim në veprimet e tij/saj në mënyrë të ngjashme me atë të interesit të shpërblyer (paguar).)

bëhen publike deklaratat e të emëruarve në poste politike, deputetëve të parlamentit dhe të të zgjedhurve vendorë. Në Letoni të gjitha deklaratat bëhen publike.

- *Kufizime dhe kontrolli i punësimit ose i aktivitetit me OJQ pas largimit nga detyra publike:* Në Portugali dhe Spanjë, gjatë dy vjetëve (Spanjë) ose tre viteve (Portugali) pas largimit nga një pozicion publik, të emëruarit e mëparshëm publikë mund të mos pranojnë të punësohen në një kompani tregtare ose private që ka qenë ose është përfshirë në një marrëdhënie kontraktuale, të rregullt ose të drejtpërdrejtë me organizatën publike ku punonin më parë. Në Gjermani, Hungari dhe Itali nuk ka kufizime të tilla. Në Poloni, të emëruarit politikë duhet të marrin pëlqimin për të pranuar emërimet të tilla përpara largimit nga detyra publike. Franca, Italia dhe MB kanë kufizime dhe kontroll për aktivitetin e punës së nëpunësve civilë pas largimit nga sektori publik dhe në Poloni ky kufizim përfshin nëpunësit publikë dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë. Periudhat e këtyre kufizimeve janë të ndryshme: një vit në Poloni, dy vjet në MB dhe pesë vjet në Francë. Në Francë ka një rregullore shumë të hollësishme mbi punësimin e nëpunësve civilë pasi largohen nga detyra, dhe në MB nëpunësit civilë duhet të raportojnë çdo kontakt me persona jashtë zyrës që ofrojnë punë, përfshirë edhe OJQ.
- *Kufizime dhe kontrolli i dhuratave dhe i përfitimeve të tjera:* MB ka një politikë shumë strikte për dhuratat. Për shembull, të emëruarit në poste politike lejohen t'i mbajnë dhuratat vetëm nëse vlera e tyre është më e vogël se 140 pounds sterling. Nëpunësit e shërbimit civil dhe deputetët e parlamentit nuk mund të pranojnë asnjë dhuratë. Në Gjermani dhe Spanjë, zyrtarët në sektorin publik nuk mund të pranojnë dhurata; në Francë, ata nuk mund të pranojnë dhurata kur ato kanë ndikim në pavarësinë e tyre. Në këtë kuadër, në Poloni ka kufizime për të emëruarit në poste politike dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë, dhe në Hungari kufizimet zbatohen për deputetët e parlamentit. Në çdo rast, dallimi ndërmjet dhuratave dhe ryshfetit është shumë i vogël, i ngushtë dhe për këtë arsye mund të arrijmë në përfundimin se në të gjitha vendet nuk është e mundur të pranohen dhurata kur ato ndikojnë seriozisht në pavarësinë e zyrtarit publik.
- *Kufizime dhe kontrolli i punësimit të dytë të njëkohshëm (për shembull në një OJQ ose parti politike):* Këto kufizime janë shumë të rëndësishme për gjyqtarët, sepse pavarësia dhe paanshmëria e tyre mund të dëmtohen nëse ata do të ishin anëtarë të partive politike. Kjo është arsyeja e ndalimit të përfshirjes në politikë të gjyqtarëve në të gjitha vendet e studiuara. Franca, Gjermania, Letonia, Polonia, Spanja dhe MB të gjitha kanë kufizime mbi punësimin e njëkohshëm të të emëruarve në poste politike në OJQ. Në Hungari, Poloni dhe MB nëpunësit civilë të nivelit të lartë nuk lejohen të mbajnë detyra të larta në parti politike.
- *Dorëheqja dhe tërheqja rutinë.* Të gjithë personat që janë në drejtim duhet të përjashtohen nga pjesëmarrja në nxjerrjen e një akti administrativ apo në lidhjen e një kontrate administrative kurdoherë që ata kanë një interes privat në vendimin që merret. Për shembull, një person i përfshirë në një procedurë administrative në emër të grupit drejtues mund të preket personalisht – ose mund të jetë i afërm i një personi të përfshirë – nga procedura administrative. Në një rast të tillë, është e përshtatshme që zyrtari publik të mbajë detyrën e tij/saj por të mos marrë pjesë në marrjen e ndonjë vendimi mbi çështjet që kanë efekt tek ai/ajo. Kjo mund të arrihet, për shembull, duke bërë që vendimi për çështjen në fjalë të merret nga një palë e tretë e pavarur ose që zyrtari në fjalë të heqë dorë nga votimi për vendimet, duke u tërhequr nga diskutimi i propozimeve dhe planeve përkatëse, ose duke mos marrë dokumentet dhe informacionin tjetër që kanë lidhje me interesin e tij/saj privat. Në të gjitha vendet e studiuara⁵, të gjithë zyrtarët publikë duhet të heqin dorë nga pjesëmarrja në nxjerrjen e një akti administrativ apo në lidhjen e një kontrate administrative kurdoherë që ata kanë një interes privat në vendimin që merret. Në Francë, Gjermani dhe Spanjë këto rregulla janë shumë të hollësishme.
- *Kufizime personale dhe familjare mbi mbajtjen e titujve të pronësisë në kompani private:* Në Francë, Letoni, Portugali, Spanjë dhe MB ka kufizime për të gjithë zyrtarët publikë për mbajtjen e titujve të pronësisë në kompanitë private kur këto kompani lidhin kontrata me sektorin publik apo kur zyrtarët publikë duhet të hartojnë rregulla, kontrollojnë apo kontraktajnë ato. Në Itali, ka disa kufizime të caktuara mbi pronësinë mbi pronën për zyrtarët e zgjedhur vendorë. Po ashtu, Italia ka kufizime për

5 Nuk ka informacion për këtë çështje në Hungari.

deputetët e parlamentit, por këto kufizime interpretohen në mënyrë shumë të rezervuar dhe nuk zbatohen në praktikë. Në Poloni, nuk lejohet që zyrtarët e zgjedhur vendorë të kenë në pronësi një biznes privat. Në Gjermani dhe Hungari nuk ka kufizime në këtë drejtim.

- *Zhveshja nga pronësia ose përmes shitjes, ose përmes arritjes së një marrëveshjeje menaxhimi besimi apo qorre.* Këto zgjidhje për heqjen dorë nga pronësia janë rregulluar në MB për të emëruarit politikë.

4. Zbulimi

4.1. *Zbulimi me sinjalizues?* Gjermania, Hungaria dhe MB kanë zhvilluar një sistem të zbulimit përmes sinjalizuesve (njerëz që raportojnë sjelljet e gabuara në sektorin publik). Vendet e tjera të analizuara nuk e kanë një sistem të tillë.

4.2. *Organ i pavarur?* Instrumentet institucionale për zbulimin dhe hetimin e konflikteve të interesit janë të ndryshme nga vendi në vend. Nuk ka element të përbashkët, përveç vështirësive për të ngritur një organ vërtet të pavarur. Zyra e për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit në Letoni gëzon një nivel të caktuar pavarësie dhe ka hapësira të gjera për hetim dhe procedim. Megjithatë, organi i vetëm realisht i pavarur është Gjykata Kushtetuese në Portugali. Me sa duket, përdorimi i gjykatës për të zbuluar konfliktet e interesave është shumë i diskutueshëm e kontradiktor dhe është kundërshtuar në shumicën e vendeve. Vendet e mëdha, dhe veçanërisht vendet me rregulla federale nuk mund të përdorin Gjykatën Kushtetuese për të zbuluar dhe hetuar konfliktet e interesave sepse gjykata është e mbingarkuar me çështje kushtetuese.

Në Gjermani dhe Hungari, zbulimi dhe hetimi kryhen përmes hierarkisë, që do të thotë se çdo epror i institucionit, pushtetit vendor apo organi ka përgjegjësi për zbulimin dhe kontrollin e konfliktit të interesave përmes kontrollit të brendshëm dhe për vendosjen e sanksioneve për shkeljet. Në Poloni, zbulimi dhe hetimi sigurohen përmes hierarkisë (mbikëqyrja ushtrohet nga kryeministri dhe ministrat në qeverisjen qendrore dhe nga guvernatorët dhe bordet vetëqeverisëse të apelit në qeverisjen vendore). Dhoma e Lartë e Kontrollit dhe Avokati i Popullit gjithashtu ndihmojnë për zbulimin dhe Thesari i Shtetit mbikëqyr pushtetin vendor.

Në MB nuk ka ndonjë organ të veçantë përgjegjës vetëm për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e zbatimit të rregulloreve mbi konfliktin e interesave. Në departamentet e qeverisjes qendrore, kjo çështje do të trajtohej nga Zyra Kombëtare e Auditimit në rolin e saj të kontrollit dhe të analizës që ajo i bën ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të shpenzimeve qeveritare. Komisioni i Auditimit kryen një rol të ngjashëm për shpenzimet e pushtetit vendor, por problemet e etikës së anëtarëve të autoriteteve vendore tashmë shqyrtohen nga Bordi i Standardeve të Anglisë (dhe organe të krahasueshme në Skoci dhe Wales), që filloi të merrte ankesa në vitin 2002. Organi më i përafërt me të në nivel kombëtar i parashikuar në Portugali është Komisioni mbi Standardet në Jetën Publike. Bordi i Standardeve, kohët e fundit, në Raportin 10 të tij të botuar në vitin 2005, ka analizuar zbatimin e Shtatë Parimeve në sektorin publik në MB.

Në Francë, një organ i pavarur kontrollon deklarimin e asetëve: Komisioni i Transparencës së Financimeve Politike (PFTC). Tre komisione të etikës profesionale kontrollojnë punësimin dhe funksionet e nëpunësve të mëparshëm civilë pas largimit nga detyra publike. Në Itali, sistemi është i komplikuar sepse ka disa organe të ndryshme përgjegjëse. Autoriteti Italian i Konkurrencës dhe Autoriteti Italian i Komunikimit (për konfliktet e interesave në fushat përkatëse të publicitetit dhe komunikimit) janë organet përgjegjëse për zbulimin dhe hetimin e konfliktit të interesave të anëtarëve të qeverisë. Konfliktet e interesave të nëpunësve civilë dhe të gjyqësorit zbulohen përmes hierarkive të tyre përkatëse. Kryetarët e dhomave kontrollojnë deputetët e parlamentit. Përveç tyre, “Komisioneri i Lartë mund të zbulojë dhe kryejë disa hetime për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit dhe formave të tjera të veprave në administratën publike”. Së fundi, Spanja do të ngrejë Zyrën e Konfliktit të Interesave (me pavarësi të vogël) përgjegjëse për konfliktet e interesave të anëtarëve të qeverisë dhe të të emëruarve në poste politike. Kryetarët e dhomave kontrollojnë deputetët e parlamentit. Konfliktet e interesave të nëpunësve civilë, të zyrtarëve të zgjedhur vendorë dhe të gjyqtarëve zbulohen përmes sistemit të hierarkisë së tyre përkatëse dhe përmes ankesave të bëra nga qytetarët që janë prekur nga vendimet e që nuk kanë qenë të paanshme.

5. Hetimi

5.1. *Kush?* Prokurorët publikë në të gjitha vendet e studiuara kryejnë hetimin penal. Në Portugali, Drejtoria Qendrore e Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Financiar dhe Korrupsionit që është pjesë e gjyqësorit gjithashtu

luan rol në hetimet penale. Në Spanjë, një zyrë e veçantë në prokurori për luftën kundër korrupsionit është përgjegjëse për hetimin e krimeve që lidhen me korrupsionin. Kjo zyrë, e krijuar në vitin 1995 me pëlqimin e partive kryesore politike spanjolle është pjesë e Prokurorisë së Përgjithshme Publike me të cilën ajo ndan normat e veprimit të të gjitha zyrave të prokurorisë. Zyra mbështetet nga disa njësi të specializuara – një në Departamentin e Thesarit (me katër inspektorë të tatimeve dhe gjashtë ndihmës inspektorë), një njësi tjetër tek Ndërhyrja e Shtetit (me dy inspektorë dhe tre administratorë), dhe dy njësi të tjera në polici (një tek Roja Civile dhe tjetra tek policia gjyqësore), me një numër të përgjithshëm personeli prej 25 vetash. Po ashtu, ndihmë jepet edhe nga 11 prokurorë publikë të specializuar për krimin ekonomik dhe mashtrimin me taksat e tatimet në Prokurorinë Publike, si edhe 21 asistentë. Të gjitha njësitë dhe prokurorët publikë janë nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Zyrës së Prokurorisë Publike.

Të gjitha vendet kryejnë kontrollin, hetimin administrativ që zakonisht kryhet nga organi/autoriteti përgjegjës për zbulimin (shih më sipër). Në Letoni, Zyra për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit heton rastet e korrupsionit dhe shkeljet e rregulloreve mbi konfliktin e interesave. Ajo mund të hetojë llogaritë bankare ose transaksionet e biznesit dhe ka akses në bazën e të dhënave të zyrës së taksave dhe tatimeve. Në Hungari, “Regjistri i Deklarimit të Pasurive dhe Zyra e Kontrollit” është organi përgjegjës për kontrollin sapo merr rastin e zbuluar nga autoritetet përkatëse. Ajo mund të kontrollojë llogaritë bankare dhe transaksionet e biznesit dhe ka akses në bazën e të dhënave të zyrës së taksave dhe tatimeve. Në Poloni, policia dhe Agjencia e Sigurisë së Brendshme ndihmojnë në procesin e hetimit nëse ka ndodhur një krim, ndërsa Thesari i Shtetit shqyrton deklaratimet e zyrtarëve vendorë. Në Gjermani, inspektorët e taksave dhe tatimeve mund të hetojnë rastet e konfliktit të interesave në rast të një mashtrimi me taksat dhe ata mund të kontrollojnë llogaritë bankare. Në Francë, nëse është kryer një krim, mund të ndihmojë Komisioni kundër Pastrimit të Parave. Në Itali, Autoriteti i Konkurrencës dhe Autoriteti i Komunikimit janë përgjegjës për hetimin e konfliktit të interesave të anëtarëve të qeverisë, por ata mund të verifikojnë llogaritë bankare dhe të dhënat e zyrës së taksave dhe tatimeve vetëm nëse kanë një urdhër nga gjykatësi.

6. Procedimi

Gjyqësor ose administrativ: Në të gjitha vendet e studiuara ekzistojnë të dyja llojet. Procedimi gjyqësor bëhet në rast të një krimi, ndërsa procedimi administrativ zbatohet kurdoherë që ka ndodhur një gabim disiplinor.

7. Sanksionet (ndëshkimet)

7.1. *Penal:* Krimet e lidhura me “konfliktin e interesave që nuk menaxhohen mirë” ekzistojnë në shumicën e vendeve të studiuara. Në Letoni, shkeljet e rregullave të konfliktit të interesit ndëshkohen me burgim deri në pesë vjet nëse i është shkaktuar dëm themelor interesit publik. Në Poloni, zyrtarët vendorë mund të dënohen me burgim deri në tre vjet për deklarim fals të interesave. Në MB, jepen ndëshkime penale për mosdeklarimin e pasurive nga deputetët e parlamentit skocez, të parlamentit të Uellsit dhe të parlamentit në Irlandën e Veriut. Sanksione të tilla vazhdojnë të aplikohen për një periudhë transitore për anëtarët e autoriteteve lokale kur ata nuk bëjnë publike interesat e tyre monetare dhe kur nuk tërhiqen nga shqyrtimi i çështjeve që mund të shkaktojnë konflikt interesi. Në Itali, anëtarët e qeverisë mund të paditen me akuza për krim nëse ata nuk dorëzojnë deklaratën e pasurisë ose nëse e dorëzojnë atë me informacion fals dhe jo në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Konkurrencës ose të Autoritetit të Komunikimit. Franca ka një krim të veçantë të quajtur “kërkimi i paligjshëm i interesit” dhe dënimi mund të jetë deri me pesë vjet burgim dhe një gjobë prej 75 000 euro. Po ashtu, në Francë është krim shkelja e kufizimeve për punësim në kompani private për të pasur përfitime monetare pas largimit nga detyra në sektorin publik; dënimi është burgim deri në dy vjet dhe gjobë prej 30 000 euro. Në Gjermani, ekziston një krim i lidhur me konfliktin e interesave të quajtur “pranimi i një avantazhi”. Neni 331 i Kodit Penal përfshin të gjitha llojet e avantazheve. Udhëzimet e ministrive rreshtojnë shembujt më të rëndësishëm:

- Para dhe avantazhe me vlerë të parave si xhetona apo kupona;
- Bizhuteri;
- Të gjitha llojet e aparaturave ose makinerive për përdorim privat, p.sh. aparaturat elektronike;

- Ulje çmimi për përdorim privat;
- Ulje e interesave të kredive;
- Pagesë e lartë e pajustificuar për një punë të dytë zyrtare;
- Punësimi i të afërmeve të nëpunësve civilë;
- Biletat, latat e udhëtimeve, darkat e shtrenjta;
- Pajisja me një banesë shumë të shtrenjtë që nuk mund të justifikohet me të ardhurat;
- Trashëgimitë;
- Honorare të veçanta;
- Ftesa në aktivitete ekskluzive;
- Avantazhe seksuale.

7.2. *Disiplinore*

7.2.1 *Pezullimi i rrogës*: Ndëshkime administrative parashikohen për nëpunësit civilë në shumicën e vendeve të studiuara. Ato janë përcaktuar edhe për gjyqtarët në Francë, Gjermani, Itali, Letoni dhe Spanjë. Në Poloni, të zgjedhurit vendorë mund të dënohen me pezullimin e rrogës, dhe në MB shkelja e Kodit të Etikës nga një deputet mund të çojë në mbajtjen e rrogës.

7.2.2 *Pushimi nga puna*: Pushimi nga puna është ndëshkimi më i rëndë administrativ për rastet e shkeljeve të rregulloreve të konfliktit të interesave në të gjitha vendet e studiuara. Në veçanti, pushimi nga puna i nëpunësve civilë dhe gjyqtarëve parashikohet në rregulloret e shumicës së vendeve. Po ashtu, edhe anëtarët e qeverisë dhe të emëruarit politikë mund të ndëshkohen me pushim nga puna në Francë, Hungari, Letoni, Poloni, Portugali dhe Spanjë (sipas projekt ligjit të ri).

7.3. *Administrative*: Ndëshkimet administrative që janë vendosur në rregullore janë: gjoba, ndëshkime morale (d.m.th. botimi i shkeljes në Gazetën Zyrtare të Kuvendit ose në Buletinin Zyrtar të shtetit), raporte Kuvendit, ndalimi për të pasur një post publik për deri në 10 vjet, dhe kthimi i mjeteve të marra në mënyrë të paligjshme.

B. Elementet e veçantë

Pas prezantimit të elementëve të përbashkët, tani do të paraqesim karakteristikat e veçanta aktuale apo të programuara të secilit vend që janë specifike, unike ose të reja. Po ashtu, do të tregojmë arsyetimin e secilës prej këtyre politikave të ndryshme.

Mbretëria e Bashkuar: Qasja e MB është e ndryshme nga qasjet e tjera sepse konflikti i interesave trajtohet si një aspekt i standardeve etike në sektorin publik. Megjithëse nuk ka një rregullore të vetme që trajton konfliktin e interesave në shërbimin publik, ka “Shtatë Parime” të jetës publike që janë miratuar nga qeveritë e njëpasnjëshme dhe tashmë janë shndërruar në kritere nëpërmjet të cilave vlerësohen standardet në jetën publike. Duke marrë parasysh rëndësinë e tyre, po i japim të plota këtu si më poshtë:

Altruizmi

Mbajtësit e detyrës publike duhet të marrin vendime vetëm në të mirë të interesit publik. Ata nuk duhet të marrin vendime për të marrë përfitime financiare apo materiale për veten e tyre, familjen e tyre apo miqtë e tyre.

Integriteti

Mbajtësit e detyrës publike nuk duhet ta vënë veten nën ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër të individëve apo organizatave të tjera që mund të ushtrojnë ndikimin e tyre në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

Objektiviteti

Në kryerjen e detyrës publike, përfshirë emërimet në sektorin publik, dhënien e kontratave apo rekomandimin e individëve për shpërblime dhe përfitime, mbajtësit e detyrës publike duhet t'i bëjnë zgjedhjet mbi bazën e meritës.

Llogaridhënia

Mbajtësit e detyrës publike japin llogari për vendimet dhe veprimet e tyre para publikut dhe duhet ta vënë veten në dispozicion të çfarëdo lloj shqyrtimi të përshtatshëm për detyrën e tyre.

Sinqeriteti

Mbajtësit e detyrës publike duhet të jenë sa më të hapur për të gjitha vendimet dhe veprimet që ata ndërmarrin. Ata duhet të japin arsyet për vendimet e tyre dhe ta kufizojnë informacionin vetëm në rastet kur kjo gjë kërkohet qartë nga interesi publik.

Ndershmëria

Mbajtësit e detyrës publike kanë për detyrë të deklarojnë çdo interes privat që ka lidhje me detyrat e tyre publike dhe të marrin hapa për të zgjidhur çdo konflikt që lind në mënyrë të tillë që të mbrojnë interesin publik.

Lidershipi

Mbajtësit e detyrës publike duhet të nxisin dhe përkrahin këto parime përmes drejtimit dhe dhënies së shembullit.”

Komisioni për Standardet në Jetën Publike (një komision i përhershëm parlamentar) shqyrton shqetësimet mbi standardet e etikës së të gjithë mbajtësve të detyrës publike (zyrtarët e qeverisjes qendrore e lokale, deputetët e parlamentit, zyrtarët e Shërbimit Kombëtar të Shëndetit dhe të organeve publike) përfshirë rregullat që lidhen me veprimtari financiare dhe tregtare. Komisioni rekomandon ndryshime në rregullat aktuale që mund të kërkohen për të siguruar standardet më të larta të mirësjelljes në jetën publike.

Po ashtu, e veçantë për MB është ngurrimi për të kërkuar bërjen të njohur të të ardhurave dhe asetëve personale e familjare dhe bërjen publike të deklaratave të tilla. MB nuk ka kërkesa të përgjithshme për deklarimin e të ardhurave dhe asetëve dhe arsyeja për këtë është të shmanget cenimi i jetës private që nënkuptojnë këto kërkesa. Qasja britanike mbështetet në idenë se çdo mbajtës i detyrës publike duhet të deklarojë çdo interes monetar apo edhe material që mund të mendohet nga të tjerët në mënyrë të arsyeshme se mund të ndikojë në veprimet e tij ose të saj. Transparenca dhe përgjegjshmëria vetjake janë çështje kyçe në sistemin britanik.

Portugalia: Një tipar interesant i qasjes në Portugali është pengesa që iu vihet kompanive në të cilat zyrtarët publikë janë aksionarë, ose në emër të tyre, ose përmes të afërmeve të ngushtë duke pasur në pronësi më shumë se 10% të kapitalit të përbashkët. Në raste të tilla, kompanitë nuk mund të marrin pjesë në tender për kontrata furnizimi apo kontrata shërbimesh për agjenci shtetërore apo institucione të tjera publike. Ashtu si në MB, edhe në Portugali kurdoherë që deputetët e parlamentit propozojnë ligje ose marrin pjesë në veprimtari parlamentare mbi çështje për të cilat ata kanë interes privat të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që mund të preket nga ai vendim në parlament, ata duhet ta deklarojnë që më parë atë interes.

Megjithatë, karakteristika më e veçantë e qasjes portugeze është roli i Gjykatës Kushtetuese në monitorimin dhe zbulimin e konfliktit të interesave në shërbimin publik. Kontrolli i përgjithshëm për mungesën e

papajtuëshmërisë së funksioneve dhe për mungesën e pengesave të çdo zyrtari ka si element kryesor deklaratën e zyrtarit në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë deklaratë, zyrtari duhet të pohojë mungesën e papajtuëshmërive dhe pengesave, duke iu referuar qartë të gjitha pozicioneve, funksioneve dhe veprimtarive të kryera si edhe pronësinë e aksioneve që ai/ajo mund të ketë. Deklarata duhet të dorëzohet tek Gjykata Kushtetuese brenda 60 ditëve pas marrjes së detyrës. Gjykata Kushtetuese shqyrton, monitoron dhe kur është e nevojshme vë ndëshkimet e parashikuara nga ligji kur konstaton shkelje ose mosrespektim të rregullave mbi papajtuëshmërinë. Nëse zyrtarët në detyrë nuk dorëzojnë këtë deklaratë, Gjykata Kushtetuese i njofton ata se kanë edhe 30 ditë afat shtesë për dorëzimin e saj, ndryshe zyrtarët e humbin mandatin e tyre. Për rritjen e efikasitetit të sistemit të monitorimit, ligji përcakton gjithashtu se sekretarët e institucioneve ku ushtrojnë funksionet e tyre zyrtarët duhet të dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese emrat e të gjithë zyrtarëve dhe datat kur ata kanë filluar detyrën e tyre.

Letonia: Letonia është një vend që ka vuajtur nga nivele të larta korrupsioni. Për ta pakësuar dhe për t'u integruar me sukses në Bashkimin Evropian, qeveria në Letoni prezantoi një strategji të gjerë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Çfarë e bën Letoninë të ndryshme nga vendet e tjera të studiuara është strategjia dhe roli i Zyrës për Parandalimin dhe Luftën kundër Korrupsionit. Zyra është një institucion interesant me detyra të gjera megjithëse nuk është e pajisur mirë me personel dhe nuk është plotësisht e pavarur (Drejtori i Zyrës emërohet për një periudhë pesë vjeçare por mund të pushohet nga parlamenti mbi bazën e rekomandimit të Këshillit të Ministrave, dhe zyrtarët e administratës qendrore dhe vendore dhe përgjegjësit e degëve rajonale të Zyrës emërohen dhe mund të pushohen nga Drejtori i Zyrës duke ndjekur udhëzime të gjera). Ndërmjet të tjerave, detyrat e Zyrës janë të:

- Hartojë strategjinë antikorrupsion dhe programin kombëtar antikorrupsion i cili miratohet më pas nga Këshilli i Ministrave;
- Bashkërendojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të përcaktuara në programin kombëtar me qëllim që të sigurohet zbatimi i programit;
- Monitorojë zbatimin e ligjit “Mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Veprimtarinë e Zyrtarëve Shtetërorë” dhe të kufizimeve të tjera shtesë për zyrtarët shtetërorë të parashikuara në aktet normative;
- Analizojë ankesat dhe letrat brenda autoritetit të vet dhe të kryejë kontrolle të propozuara nga Presidenti i Letonisë, Saeima (parlamenti), Këshilli i Ministrave dhe Prokurori i Përgjithshëm;
- Hartojë dhe analizojë rezultatet e këtyre kontrolleve, informacionin që përmbajnë deklaratat e dorëzuara nga zyrtarët shtetërorë, çdo shkelje të gjetur në këto deklarime dhe mosrespektimin e kufizimeve të parashikuara nga ligji;
- Shqyrtojë deklaratimet e zyrtarëve shtetërorë në kuadër të Ligjit “Mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Veprimtarinë e Zyrtarëve Shtetërorë”.
- Ngarkojë zyrtarët shtetërorë me përgjegjësi administrative dhe të vendosë ndëshkime në rastet e shkeljeve administrative në fushën e korrupsionit siç parashikohet në ligj;
- Kryejë hetime dhe veprime operacionale për të zbuluar vepra penale në fushën e korrupsionit në Shërbimin Civil Kombëtar, siç parashikohet në Kodin Penal;
- Monitorojë përputhshmërinë e organizatave politike (partive) me rregulloret për financimin e partive.

Franca: Sipas informacionit në dispozicion për qasjen franceze, ka një rregullore shumë interesante mbi konfliktin e interesave të nëpunësve civilë. Franca ndoshta ka rregulloren më të mirë mbi veprimtarinë e nëpunësve civilë pas emërimit në detyrë. Ajo ka gjithashtu edhe një sistem shumë strikt të veprimtarive që nuk janë në përputhje me veprimtarinë në shërbimin civil. Kontrolli dhe zbulimi i aktiviteteve që janë të papajtuëshme me veprimtarinë e shërbimit civil dhe i shkeljeve pas emërimit në detyrë kryhen përmes kontrollit hierarkik. Megjithatë, ka edhe tre komisione të etikës profesionale (një për shërbimin civil në nivel qendror, një për shërbimin civil në nivel qarku dhe vendor dhe një për shërbimin kombëtar të shëndetit) mendimi i të cilave duhet të merret përpara se një zyrtar të largohet nga shërbimi në sektorin publik dhe të

pranojë një pozicion në sektorin privat. Këto komisione mund të hapin një proces të drejtë ligjor për të grumbulluar të gjitha faktet përkatëse dhe, pas dëgjimit të të gjitha palëve të interesuara, përgatisin një rezolutë jo të detyrueshme për zbatim mbi procesin e konsultimit. Rezoluta i çohet autoritetit administrativ që ka përgjegjësinë ligjore për të marrë vendime. Kjo rezolutë mund të deklarojë pozicionin në sektorin privat si të pajtueshëm, të papajtueshëm ose të pajtueshëm me disa kushte të caktuara. Një tipar tjetër interesant i qasjes franceze është ekzistenca e një krimi të veçantë lidhur me konfliktin e interesave që quhet si “kërkimi i paligjshëm i interesit”. Çdo nëpunës civil apo punonjës publik mund të akuzohet për këtë krim nëse ai/ajo pranon një pozicion në një kompani që ka qenë nën kontrollin e tij/saj në pesë vitet e fundit. Po ashtu, është vepër penale për çdo zyrtar publik (përfshirë një zyrtar të zgjedhur) të ketë, të marrë ose të mbajë një detyrë në një kompani që aktualisht është nën kontrollin e tij/saj. Megjithatë, rregullorja mbi konfliktin e interesave dhe papajtueshmërisë së funksioneve për zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruarit politikë është shumë e butë, dhe sistemi i kontrollit dhe zbulimit mund të ketë nevojë për disa përmirësime.

Hungaria: Hungaria ka një qasje të tillë që është kryesisht juridike mbështetur në ligjet dhe rregulloret në fuqi për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Kur analizohet sistemi hungarez, mund të vihet re qartë ndikimi francez mbi rregulloret. Për shembull lejohet që zyrtarët e zgjedhur vendorë të jenë edhe deputetë parlamenti: kryetarët e bashkive mund të zgjidhen si deputetë parlamenti. Në vitin 2004, Hungaria krijoi një organ konsultativ të quajtur “Organi konsultativ i jetës publike pa korrupsion”, i cili ka funksione të ngjashme me organin francez “Shërbimi Qendror për Parandalimin e Korrupsionit”. Është interesante se si rregullohet papajtueshmëria e funksioneve të nëpunësve civilë. Sipas ligjit ka tre lloje të nëpunësve civilë: nëpunës civilë të zakonshëm, nëpunës civilë që punojnë në shërbimet publike si shëndetësi apo arsim; dhe nëpunës civilë që punojnë në fushën e sigurisë publike. Secili prej llojeve ka rregulloren e vet. Problemet me këtë qasje janë mungesa e koherencës dhe kontradiktat ndërmjet rregulloreve. Një tipar interesant i sistemit hungarez është se nuk lejohet të kesh një pozicion si nëpunës civil në një fushë ose shërbim ku përfshihen interesa të familjes. Sigurisht, kjo zbatohet vetëm kur nëpunësi civil ka detyrë të kontrollojë apo të monitoroj atë fushë. Megjithatë, dobësitë kryesore të kësaj qasjeje janë mungesa e rregullores së veçantë për konfliktin e interesave dhe mungesa e pavarësisë së organeve përgjegjëse për zbulimin dhe hetimin e konfliktit të interesave.

Polonia: Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (CPI) të vitit 2005 të Transparency International, Polonia ka një pikavarazh prej 3.4 (10 është rezultati më i mirë i mundshëm). Ky është një pikavarazh shumë i ulët. Këto të dhëna mund të shpjegojnë rëndësinë që i jepet në Poloni një strategji gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit. Kjo strategji ekziston dhe politikat mbi konfliktin e interesave janë në kuadër të kësaj strategjie të gjerë. Sigurisht, një numër ligjesh dhe instrumentesh të tjera që trajtojnë aspekte të ndryshme të administratës publike dhe veprimtari të nëpunësve publikë dhe të zyrtarëve publikë në përgjithësi përbëjnë kuadrin e politikës së konfliktit të interesave. Amendimet për përmirësimin e legjislacionit aktual filluan në fillim të viteve 90 (1990), ndërsa pjesa më e madhe e standardeve të reja legjislative kanë hyrë në fuqi në mes të viteve 90 (1997). Tashmë mund të themi se në Poloni kuadrin legjislativ mbi konfliktin e interesave është i plotë dhe i hollësishëm.

Sistemi i dorëheqjes ose “heqjes dorë” apo tërheqjes i rregulluar në Kodin e Procedurave Administrative është interesant, meqenëse ai ofron alternativën e përjashtimit nga pjesëmarrja (pezullimi) në rastin kur vihet në pikëpyetje paanshmëria e nëpunësit publik. Lista e arsyeve për pezullim e parashikuar në ligj ndoshta është e paplotë dhe ligji ka përdorim të kufizuar, por është një rregullore interesante. Po ashtu, interesante janë edhe ndalimet specifike në procedurat e prokurimit publik që e pengojnë një zyrtar të veprojë në emër të një pale urdhëruese. Së fundi, procedura e bërjes publike të interesave private për nëpunësit civilë është e shkëlqyer, me tre hapat e tij – përpara punësimit, gjatë punësimit dhe pas largimit nga puna në sektorin publik.

Megjithatë, megjithëse sistemi ligjor është i plotë dhe i hollësishëm, politika mbi konfliktin e interesave nuk funksionon. Cili është problemi? Ka dy pika të dobëta të rëndësishme në qasjen polake: ligjet nuk zbatohen plotësisht dhe nuk ka asnjë organ të veçantë e të pavarur përgjegjës për zbulimin dhe hetimin e konflikteve të interesit. Qeveria duhet të mendojë për ngritjen e një sistemi efikas të kontrollit, një qendër koordinimi për të monitoruar zbatimin e programeve dhe të rregulloreve e sanksioneve të përcaktuara qartë dhe për ngritjen e autoritetit përgjegjës për zbatimin e ndëshkimeve.

Gjermania: Qasja gjermane është e thjeshtë, mbështetur kryesisht në idenë se çdo zyrtar publik, veçanërisht kur ai/ajo kryen një procedurë administrative, duhet të deklarojë apo të japë informacion mbi interesat private (monetare ose edhe materiale) që mund të mendohet nga të tjerët në mënyrë të arsyeshme se ka ndikim në veprimet e tij/saj publike. Vetëm përgjegjësi i departamentit ose organi më lart në hierarki mund të vendosë nëse personi që ka deklaruar anësinë e tij/saj duhet të përjashtohet apo jo. Nëse personi përjashtohet nga një procedurë administrative, ai/ajo mund të mos marrë pjesë në aktivitete që do të kishin ndikim në vendimin që merret për atë procedurë.

Përveç këtyre, tre karakteristika të qasjes gjermane që ia vlen të përmenden janë:

1) Rëndësia e sistemit juridik. Është e pamundur të kuptohet modeli gjerman pa marrë në konsideratë se Gjermania është një shtet juridik (Rechtstaat). Politikat e saj mbështeten në parime juridike dhe duhet të zhvillohen në përputhje me sistemin ligjor. Për qëllimet tona, parimi më i rëndësishëm është se ligji duhet të zbatohet njëloj për të gjithë dhe se procedurat duhet të jenë të drejta. Marrëdhënia ndërmjet administratës publike dhe personave privatë drejtohet nga detyrimi i administratës për të mbështetur personin privat gjatë ushtrimit të të drejtave të tij/saj.

2) Në Gjermani, ashtu si në MB është e rëndësishme jo vetëm të shmangët një konflikt real interesi, por gjithashtu të shmangët përshtypja e kryerjes së një veprimi të gabuar. Zyrtari publik është i detyruar të shmangë të gjitha veprimtaritë që mund të japin përshtypjen se ai/ajo përgatitet të kryejë shkelje të detyrave dhe të ligjeve.

3) Të gjitha vendimet e gjykatës dhe të administratës publike duhet të motivohen kur ato ndërhyjnë tek të drejtat dhe liritë e individit. Motivimi kërkon që gjyqtari apo zyrtari publik të pasqyrojë me shkrim se çfarë vendimi do të marrë. Kjo procedurë quhet “veprimi i paralajmërimit” ose “vetëkontrolli”.

Për të garantuar parimin e barazisë dhe për të shmangur përshtypjen e kryerjes së sjelljeve të gabuara, modeli gjerman ka krijuar një sistem të hollësishëm për dorëheqjen dhe heqjen dorë. Të gjithë personat që veprojnë në emër të administratës duhet të përjashtohen nga përgatitja e një akti administrativ ose lidhja e një marrëveshje administrative kurdoherë që, për shembull:

- Personi përfshihet në një procedurë administrative në emër të administratës dhe njëkohësisht si një person i interesuar;
- Personi është i afërm i një personi që preket nga procedura administrative;
- Personi vepron në emër të dikujt që preket nga procedura administrative;
- Personi është i afërm i dikujt që vepron në emër të një personi që preket nga procedura administrative;
- Personi është një punonjës tek një person që preket nga procedura administrative (ky rregullim ka për qëllim të shmangë konfliktin e besnikërisë dhe të interesit);
- Personi ka dhënë një ekspertizë mbi çështje që kanë lidhje me vendimin mbi procedurën administrative.

Në Gjermani, zbulimi i konfliktit të interesave bazohet në kontrollin hierarkik dhe në të drejtën e qytetarëve për t’u ankuar. Nëse personi i interesuar gjykon se një zyrtar publik i anshëm mori pjesë në procedurë, ai/ajo mund të ankohet për vendimin, dhe nëse provohet që ai/ajo ka të drejtë, atëherë vendimi apo rezultati i procedurës është i paligjshëm apo i pavlefshëm. Së fundi, ndëshkimet penale ose disiplinore zbatohen për nëpunësin publik të përfshirë vetëm nëse shkelja e rregulloreve të konfliktit të interesave ka qenë e qëllimshme ose si pasojë e pakujdesisë.

Italia: Italia është shembulli më i qartë i pasojave negative të mungesës së një rregulloreje të gjerë mbi konfliktin e interesave. Italia ka një rregullore të pranueshme mbi konfliktin e interesave për nëpunësit civilë, gjyqtarët dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë. Për shembull, Kodi i Etikës për nëpunësit civilë që është miratuar në 28 nëntor 2000 thekson se “punonjësi ruan një pozitë pavarësie me qëllim që të shmangë marrjen e

vendimeve apo kryerjen e veprimtarive që kanë lidhje me detyrat e tij në situata kur ka konflikt real apo të mundshëm të interesave. Ai nuk kryen asnjë veprimtari që është në konflikt me kryerjen e drejtë të detyrave gjatë punës së tij dhe ndërmerr veprime për të shmangur situata dhe sjellje që mund të dëmtojnë interesat apo imazhin e administratës publike” (neni 2.3); “Punonjësi heq dorë nga pjesëmarrja në marrjen e vendimeve ose veprimtari që mund të përfshijnë interesat e tij personale ose ato të të afërmeve ose të bashkëjetuesve” (neni 6.1).

Punonjësi “heq dorë, edhe nëse aktualisht nuk ka ndonjë konflikt interesi në qoftë se pjesëmarrja e tij në miratimin e një vendimi ose në një veprimtari mund të sjellë mungesën e besimit tek pavarësia dhe paanshmëria e administratës” (neni 6.3).

Megjithatë, mungesa e një rregulloreje të tillë për anëtarët e qeverisë (përfshirë kryeministrin) ka sjellë shtrembërime shumë të rënda në demokracinë italiane. Fakti që i bëri të dukshme këto probleme ishte zgjedhja në postin e kryeministrit të njeriut më të pasur në Itali dhe pronarit të kompanisë më të rëndësishme të komunikimit. Pas debatesh dhe diskutimesh të gjata midis vetë politikanëve dhe opinionit publik, çështja e konfliktit të interesave ndërmjet detyrës politike dhe kryerjes së aktiviteteve dhe profesioneve të ndryshme është trajtuar kohët e fundit në një ligj: Ligji nr. 215 i datës 20 korrik 2004, që hyri në fuqi në 2 shtator 2004. Në bazë të ligjit të ri, politikanët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre duhet të kujdesen vetëm për interesat publike, dhe si pasojë, në rastet e konfliktit të interesave, nuk duhet të veprojnë dhe të marrin pjesë në vendimet e bordeve politike. Sipas ligjit, për raste specifike të konfliktit të interesave në fushën e botimeve, Autoriteti i Konkurrencës dhe Autoriteti i Komunikimit janë përgjegjëse për kontrollin dhe parandalimin e konfliktit të interesave. Dispozitat e kombinuara të neneve 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 215 përcaktuan fushën e veprimit të këtyre funksioneve kontrolluese dhe parandaluese.

Neni 1 thekson se Kryeministri, ministrat, sekretarët e shtetit dhe komisionerët e jashtëzakonshëm të qeverisë janë të gjithë “zyrtarë që mbajnë poste qeveritare” (dhe për rrjedhojë janë palë mbi të cilat vepron ligji). Neni 1 (1) i detyron zyrtarët qeveritarë t’u përkushtohen vetëm “detyrave në interes të publikut”, dhe i ndalon ata “të kryejnë veprime dhe të marrin pjesë në vendime kolektive që kryhen në situata të konfliktit të interesave”.

Neni 2 rendit të gjitha veprimtaritë që janë në konflikt interesi me mbajtjen e një posti qeveritar (për shembull çdo lloj pune në sektorin publik apo privat, ose kryerjen e veprimtarive profesionale në fusha të lidhura me detyrën qeveritare në fjalë). Zgjedhja ndërmjet papajtueshmërisë së funksioneve dhe mungesës së të drejtës për të kandiduar në zgjedhje ka të bëjë me qëllimet e ndryshme të këtyre dy institucioneve në sistemin juridik italian. Qëllimi i papajtueshmërisë së funksioneve është të garantojë që përfaqësuesit e zgjedhur i kryejnë si duhet detyrat e tyre kur ata janë në rrethana personale që teorikisht mund të vinin në rrezik kryerjen e drejtë të detyrave.

Neni 3 përcakton konceptin e “konfliktit të interesave” duke iu referuar dy situatave të ndryshme dhe alternative (siç vihet në dukje nga përdorimi i lidhëses “ose”): “a) ekzistenca e një prej situatave të papajtueshmërisë të renditura në nenin 2; b) kur masa ose moskryerja e veprimit ka një efekt të veçantë, preferencial mbi pasurinë e zyrtarit ose bashkëshortit/bashkëshortes ose të afërmeve deri në shkallë të dytë ose të kompanive apo sipërmarrjeve të tjera të kontrolluara prej tyre, sipas kuptimit të pjesës 7 të Ligjit nr. 287 datë 10 tetor 1990 në dëm të interesi publik”. Një karakteristikë që ia vlen të përmendet është se veprimi që krijon konfliktin e interesave është jo vetëm ai që kryhet nga zyrtari i postit publik, por edhe veprimi që nuk kryhet por që duhet të ishte kryer.

Rregullorja mbi konfliktin e interesave është plotësuar duke dhënë me hollësi detyrat, funksionet dhe procedurat e autoriteteve të pavarura administrative përgjegjëse për mbikëqyrjen, parandalimin dhe vendosjen e ndëshkimeve për të luftuar raste të tilla. Për kompanitë në përgjithësi, kjo përgjegjësi është e Autoritetit të Konkurrencës, përcaktuar me Ligjin nr. 287/1990 (neni 6). Për kompanitë në shtypin e shkruar dhe sektorin e medias kjo përgjegjësi është jo vetëm e Autoritetit të Konkurrencës por edhe e Autoritetit Rregullator të Komunikimit përcaktuar me Ligjin nr. 249/1997. Autoritetet e mësipërme kanë kompetenca të gjera për të kryer hetime dhe vendosur ndëshkime në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi. Po ashtu, ato mund të veprojnë edhe me iniciativën e tyre duke garantuar parimin e *audi alteram partem* dhe rregullat e transparencës administrative. Funksionet e tyre nuk i përjashtojnë funksionet e gjykatave apo të autoriteteve

të tjera që merren me veprat penale, civile, administrative apo disiplinore dhe sigurisht atyre iu kërkohet të raportojnë të gjitha rastet e veprave penale tek autoritetet gjyqësore⁶.

Megjithatë ka dy probleme me Ligjin nr. 287. Problemi i parë është se është e vështirë të verifikohet “në dëm të interesit publik” që kërkohet nga pjesa e fundit e përkufizimit sepse përfshihet një vlerësim arbitrar i një objekti të paprekshëm. Gjithnjë është e mundshme të verifikohet një interes publik që mbrohet nga një vendim publik dhe një që është sakrifikuar, por përcaktimi nëse përfitimi peshon më shumë tek sakrificat apo e kundërta është një vendim politik, dhe si i tillë është arbitrar. Opozita aktuale në Itali ka deklaruar qëllimin e saj për të ndryshuar këtë rregullore ineficiente kur të vijë në pushtet. Problemi i dytë i ngritur nga autorë të ndryshëm dhe nga Këshilli i Europës është se Ligji nr. 215 nuk përfshin “*pronësinë si të tillë*” të një kompanie ndërmjet rasteve të papajtueshmërisë ose rasteve të konfliktit të interesave. Duke marrë në konsideratë këto dy dobësi, do të arrinim në përfundimin se ligji nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problemin e konfliktit të interesave të Kryeministrit dhe të anëtarëve të qeverisë në Itali.

Spanja: Rregullat për dorëheqjen dhe heqjen dorë janë të formuluara shumë mirë dhe janë shumë të hollësishme. Kurdoherë që ka një konflikt interesi midis interesit publik dhe interesit privat të një zyrtari publik në një procedurë administrative, zyrtari publik në fjalë duhet ta deklarojë atë dhe duhet të kërkojë leje për të mos marrë pjesë në atë procedurë. Vetëm shefi i departamentit ose organi më lart epror mund të vendosë nëse personi që ka deklaruar anësinë e tij/saj do të përjashtohet apo jo. Megjithatë, nëse zyrtarët publikë të përfshirë nuk deklarojnë interesat e tyre private, ata u nënshtrohen masave disiplinore.

Rregulloret mbi shërbimin civil (mbështetur në modelin francez) janë gjithashtu shumë të hollësishme në përshkrimin e detyrave, kundërvajtjeve dhe pasojave disiplinore megjithëse konflikti i interesave nuk është pjesë e rregullave të tyre. Kjo situatë do të ndryshojë nëse ligji i ri mbi shërbimin civil përgatitur tashmë nga qeveria miratohet nga parlamenti në muajt e ardhshëm sepse ai do të përfshijë një regjim rregullator mbi konfliktin e interesave si edhe Kodin e Etikës. Qasja për të trajtuar konfliktin e interesave të deputetëve dhe senatorëve është kryesisht parandaluese dhe formale, mbështetur në deklarimin me shkrim të interesave. Megjithatë, disiplina e kërkuar nga grupet parlamentare e pengon mbrojtjen në praktikë të interesave private të individëve të veçantë të parlamentit. Ata janë të detyruar të ndjekin udhëzimet e drejtuesit të partisë dhe përgjithësisht nuk kanë hapësirë për të manovruar për mbrojtjen e interesave të tyre private.

Në çdo rast, tipari më interesant i modelit të ri spanjoll është rregullorja për zyrtarët e lartë dhe anëtarët e qeverisë. Kjo rregullore shoqërohet me dy akte: Kodi i Qeverisjes së Mirë të anëtarëve të qeverisë dhe të zyrtarëve të lartë të administratës së përgjithshme shtetërore që tashmë është në fuqi dhe Akti mbi Konfliktin e Interesave që është aktualisht në fazat e fundit të procesit parlamentar.

Në lidhje me Kodin e Qeverisjes së Mirë është interesante të vihet në dukje se raporte të njëpasnjëshme të organizmave ndërkombëtare si GRECO 2001 treguan se Spanja nuk kishte Kodin e Etikës në administratën e vet publike. Megjithëse kishte norma ligjore, nuk ishin hartuar dhe zbatuar Kodet e Etikës për të orientuar dhe ndihmuar punonjësit. Si rezultat, qeveria aktuale në përputhje me manifestin e OECD për zgjedhjet dhe udhëzimet për këtë çështje, në shkurt të vitit 2005 miratoi Kodin e Qeverisjes së Mirë. Qëllimi i tij është t’u ofrojë qytetarëve “angazhimin se të gjithë zyrtarët e lartë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre duhet të veprojnë jo vetëm në përputhje me detyrimet e parashikuara në ligje, por përveç kësaj, veprimet e tyre duhet të frymëzohen edhe nga parimet etike dhe kodet e etikës”.

Disa prej parimeve që zyrtarët e lartë duhet të respektojnë janë:

- *Transparenca e informacionit*

Zyrtarët e lartë duhet t’u ofrojnë qytetarëve informacion mbi veprimtarinë e institucioneve publike për të cilat ata kanë përgjegjësi dhe kur ata kryejnë fushata informimi, ata duhet të shmangin çdo veprim që shkon përtej informimit.

- *Ruajtja e dokumenteve*

6 Bono, Sabrina, “Mbi Pajtueshmërinë e Ligjit Fratini me Standardet e Këshillit të Europës në fushën e Lirisë së Shprehjes dhe Pluralizmit në Media”, Presidenca e Këshillit të Ministrave, Itali.

Zyrtarët e lartë duhet të garantojnë vazhdimësinë e ruajtjes së dokumenteve dhe dorëzimin e tyre tek drejtuesit e rinj në të ardhmen.

- *Shërbimi në sektorin publik me kohë të plotë*

Zyrtarët e lartë të administratës së përgjithshme shtetërore duhet të heqin dorë nga pranimi i punës dhe pozicioneve drejtuese në organizata që kufizojnë praninë dhe përkushtimin e tyre ndaj përgjegjësive që ushtrojnë.

- *Rreptësi në përdorimin e kompetencave*

Zyrtarët e lartë duhet të shmangin veprimet e papërshtatshme ose mburravece që ulin dinjitetin me të cilin duhet të ushtrohet detyra publike.

- *Ndalimi për pranimin e dhuratave*

Çdo dhuratë si edhe çdo favor apo shërbim në kushte favorizuese që shkon përtej mirësjelljes së zakonshme dhe që kushtëzon kryerjen e detyrave të zyrtarit duhet të kundërshtohet. Në rast se dhuratat janë shumë të rëndësishme, ato bëhen pronë e trashëgimisë shtetërore.

- *Promovimi i mjedisit kulturor*

Mbrojtja e mjedisit kulturor dhe e larmisë gjuhësore duhet të frymëzojnë veprimtarinë e zyrtarëve të lartë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

- *Mbrojtja dhe respektimi i barazisë gjinore*

Në veprimtarinë e tyre administrative dhe veçanërisht në miratimin e vendimeve, zyrtarët e lartë duhet të nxisin respektimin e barazisë gjinore dhe të zhdukin të gjitha pengesat që mund të krijojnë vështirësi në këtë aspekt.

- *Objektiviteti*

Veprimet e zyrtarëve të lartë duhet të përbëjnë themelin për të pasur konsiderata objektive të orientuara drejt interesit të përbashkët krahasuar me ndonjë faktor tjetër që shpreh interesat e kompanisë, të familjes apo personale ose pozicione të tjera që janë në kundërshtim me këtë interes. Ata duhet të heqin dorë nga të gjitha llojet e angazhimeve që mund të venë në rrezik objektivitetin e administratës.

- *Paanshmëria*

Në veprimet e tyre, zyrtarët e lartë duhet të heqin dorë nga ndërmarrja e një aktiviteti privat apo interesi që mund të përbëjë rrezik për të shkaktuar konflikt interesi me detyrën e tyre publike.

- *Neutraliteti*

Zyrtarët e lartë nuk duhet të përshpejtojnë ose nuk duhet të ushtrojnë ndikim në procedurat me dokumentet ose procedurat administrative pa pasur një arsye të fortë.

Sekretari i Shtetit për Administratën Publike raporton çdo vit në Këshillin e Ministrave mbi shkeljet e mundshme të këtyre parimeve me qëllim që të korrigjohen procedurat e gabuara dhe të propozohen masat e përshtatshme për të garantuar objektivitetin e vendimeve të administratës. Ndëshkimi do të përfshinte pushimin nga puna.

Në lidhje me normën e dytë, qëllimi i aktit ligjor të qeverisë mbi Rregullimin e Konfliktit të Interesave të anëtarëve të qeverisë dhe të zyrtarëve të lartë të administratës së përgjithshme shtetërore është “të përcaktojë detyrimet që u takojnë anëtarëve të qeverisë dhe zyrtarëve të lartë të administratës së përgjithshme shtetërore për parandalimin e situatave që mund të shkaktojnë konflikt të interesave”.

Ky ligj u përgatit duke pasur në konsideratë kufizimet e ligjit aktual në fuqi. Pas vlerësimit të zbatimit të rregullores mbi papajtueshmërinë e funksioneve për zyrtarët e lartë, që në vitin 2005 u pranua se kishte nevojë për një reformë urgjente. Rregullorja përcakton papajtueshmëri absolute me çdo pozicion tjetër si edhe ndalim të të pasurit në pronësi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të më shumë se 10% të aksioneve në një kompani që ka kontratë me sektorin publik. Për më tepër, ajo e detyron zyrtarin të bëjë deklarinimet e mëposhtme: deklarinimin e aktivitetit pas fillimit të detyrës, deklarinimin e pasurisë dhe të të drejtave dhe deklarinimin vjetor të të ardhurave.

Megjithatë, ky akt ligjor ka disa mangësi, boshllëqe që mund të pengonin zbatimin praktik të tij. Shkelja e kësaj rregulloreje ndëshkohet me botimin e shkeljes në Fletoren Zyrtare të Shtetit dhe hetimi i veprimtarisë së supozuar të parregullt kryhet nga një njësi që nuk ka pavarësi organike apo funksionale nga qeveria. Sigurisht, problem kryesor aktual është se kontrolli i deklarinimit dhe hetimi i veprimtarive të papajtueshme i janë dhënë një organi të papërshtatshëm. Pavarësisht nga pranimi i profesionalizmit të punonjësve të Njësisë së Kontrollit të Shërbimeve në Ministrinë e Administratës Publike, është e qartë se kjo njësi nuk ka mundësi reale për të deklaruar konfliktin e interesave apo papajtueshmërinë e funksioneve të një ministri të një apo sekretari shteti. Punonjësit e kontrollit kanë pozicione që janë të një rangu me postin e zëvendës drejtorit dhe i nënshtrohen parimit të hierarkisë. Për më tepër, ata nuk kanë as kapacitetin për të hetuar e as mundësinë për të kërkuar praninë dhe deklarinimin e zyrtarëve të lartë. Si pasojë, roli i kontrollit është ai i regjistrimit të dokumenteve që as nuk mund t'i analizojë.

Duka marrë në konsideratë të gjitha këto rrethana, qeveria spanjolle e mendoi të rëndësishme vazhdimin e reformave. Karakteristikat më të rëndësishme të ligjit të fundit të qeverisë që po diskutohet tani në parlament janë si më poshtë:

1. Regjimi rregullator i papajtueshmërive: më i shtrënguar, më kërkuar dhe më i qartë

Zyrtarët e lartë ushtrojnë funksionet e tyre me përkushtim të plotë dhe nuk duhet të kombinojnë këtë veprimtari me ndonjë pozicion tjetër, me natyrë publike apo private, vetëm ose me të tjerë për të cilin mund të marrin shpërblym.

2. Kufizime për ushtrimin e aktiviteteve private

Për një periudhë kohore prej dy vjetësh pas ndërprerjes së detyrës publike, zyrtarët e lartë nuk mund të punojnë në kompani pune ose private që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me funksionet e kryera më parë në shërbimin publik. Lidhje e drejtpërdrejtë ekziston në rastet e mëposhtme:

- Në rastin e zyrtarëve të lartë, kjo zbatohet për eprorët e tyre dhe për të gjithë shefat e organeve në varësi, përmes delegimit ose zëvendësimit, që kanë marrë vendime në lidhje me kompanitë e përfshira.
- Po ashtu, lidhja e drejtpërdrejtë përdoret kurdoherë që personat e sipërpërmendur kishin marrë pjesë në një seancë kolegjiale ku ishte arritur një marrëveshje me këto kompani.

Anëtarët e qeverisë dhe zyrtarët e lartë nuk e shkelin rregulloren e papajtueshmërisë së funksioneve kur ata kthehen të punojnë në atë kompani ku kishin punuar përpara se të emëroheshin në shërbimin publik për sa kohë që veprimtaria e tyre në sektorin privat nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencat e mëparshme ose për sa kohë që ata nuk mund të marrin vendime në lidhje me atë detyrë.

3. Deklarimi i pasurisë (të mirave dhe të drejtave)

Deklaratat e pasurisë që duhet të paraqesin sekretarët e shtetit dhe ministrat në Regjistrin e Veprimtarive, të Mirave dhe Trashëgimisë botohen në Fletoren Zyrtare të Shtetit. Për më tepër, zyrtarët e lartë duhet të paraqesin deklarinimin e pasurisë në fillim dhe në fund të veprimtarisë së tyre dhe çdo vit ata duhet të plotësojnë deklaratën e tatimeve mbi të ardhurat dhe mbi fitimet kapitale.

4. Kontrolli dhe menaxhimi i vlerave dhe asetëve financiare

Asetet financiare të zyrtarëve të lartë menaxhohen në një fond “të verbër”, pa dijeninë e atyre që janë të interesuar.

5. *Organet e menaxhimit, vigjilencës dhe kontrollit*

Zyra e Konfliktit të Interesave është krijuar si pjesë e portofolit të Ministrisë së Administratës Publike. Ajo është organi përgjegjës për menaxhimin e Regjistrimit të Veprimtarive, të Mirave dhe Trashëgimisë, dhe ajo është përgjegjëse për ruajtjen, sigurinë dhe integritetin e të dhënave dhe dokumenteve të atij Regjistri. Kjo ngre dyshime të arsyeshme nëse kjo Zyre ka pavarësi të mjaftueshme për të kryer funksionet e veta sepse Zyra është në varësi të qeverisë.

6. *Regjimi i ndëshkimeve*

Ndëshkime të veçanta, fillimi i procedimit, botimi në Fletoren Zyrtare të Shtetit dhe njoftimi i punëdhënësit zbatohen për çdo zyrtar të lartë që shkel rregulloren mbi papajtueshmërinë e funksioneve. Çdo zyrtar që shkel rregulloren pushohet nga puna nëse është akoma në detyrë, humb të drejtën për kompensim me pension dhe është i detyruar të kthejë sasinë e marra.

Punëdhënësi nuk punon më me pushtetin në nivel qendror, rajonal dhe vendor nëse ai/ajo vazhdon të mbajë në punë një ish zyrtar të lartë që ka shkelur rregulloren mbi papajtueshmërinë e funksioneve gjatë periudhës së përcaktuar (dy vjet pas largimit nga detyra). Zyrtarët e lartë që shkelin këtë rregullore nuk kanë mundësi të mbajnë një detyrë në sektorin publik për një periudhë kohore pesë deri në dhjetë vjet.

Të dyja normat kanë për qëllim të arrijnë të njëjtat rezultate: përmirësimin e besimit të qytetarëve tek qeveria dhe administrata e tyre, dhe parandalimin e shkeljeve të parimeve të paanshmërisë, neutralitetit dhe objektivitetit që shpallin Kushtetuta dhe ligjet spanjolle në emër të qeverisë dhe administratës. Megjithatë, sfida më e rëndësishme është zbatimi i këtyre normave dhe garantimi që çdo njeri që shkel ligjet dënohet. Përvoja në Spanjë mbi zbatimin dhe përdorimin e ndëshkimeve disiplinore nuk ka qenë shumë e kënaqshme.

Një zhvillim interesant po ndodh në komunitetin e pavarur spanjoll të Katalonias ku parlamenti po diskuton mbi një ligj për ngritjen e një zyre kundër mashtrimit dhe kundër korrupsionit që do t'i raportojë parlamentit. Ngritja e kësaj zyre ka marrë frymëzimin nga Zyra Europiane e luftës kundër Mashtrimit (OLAF).

III. PËRMBLEDHJE E NËNTË RASTEVE

Mbretëria e Bashkuar: Rregullorja britanike mbi konfliktin e interesave është më e vjetra. Ligji mbi Parandalimin e Korrupsionit është hartuar që në vitin 1889. Qasja britanike mbështetet në idenë se konflikti i interesave nuk është aspekt i standardeve etike në sektorin publik. Shtatë Parimet e jetës publike zbatohen për të gjithë punonjësit në sektorin publik dhe Komisioni mbi Standardet në Jetën Publike jep rekomandime për të gjithë ata.

Portugalia: Qasja portugeze ka një ndikim të fortë britanik, por ka edhe masa të ndryshme që nuk e mbrojnë shumë jetën private, të tilla si deklarimi i të ardhurave dhe pasurisë dhe bërja publike e tyre. Arsyeja për këtë qasje të rreptë është pakënaqësia e publikut me rastet e korrupsionit të zbuluara në Portugali në vitet e fundit dhe mungesa e besimit të publikut tek aftësia e administratës dhe gjyqësorit për të vepruar në mënyrë efikase.

Letonia: Rregulloret mbi konfliktin e interesave në Letoni janë pjesë e një politike më të gjerë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Qasja letoneze mbështetet në ekzistencën e një Zyre shumë të fuqishme përgjegjëse për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit.

Franca: Çfarë është tipari më dallues tek qasja franceze është shqetësimi i saj për veprimtarinë e nëpunësve civilë pas punësimit në sektorin publik. Po ashtu, kjo qasje shquhet për vendosjen e ndëshkimeve penale në rast të kërkimit të interesit privat gjatë ushtrimit të detyrës publike dhe në rast të punësimit pas largimit nga detyra publike në kompani që janë kontrolluar gjatë pesë viteve të fundit.

Hungaria: Hungaria ka një sistem të plotë rregullash dhe rregulloresh mbi papajtueshmërinë e funksioneve, por i mungon një rregullore mbi konfliktin e interesave si edhe një organ i pavarur që është i nevojshëm për të zbuluar dhe hetuar me paanshmëri konfliktin e interesave.

Polonia: Polonia është vendi me perceptimin më të lartë të korrupsionit në të gjitha vendet e studiuara në këtë raport. Arsyet për këtë perceptim janë komplekse dhe është vështirë të përmblihen, por është e rëndësishme të merret në konsideratë një çështje: shoqëria polake nuk e lidh konfliktin e interesave me korrupsionin. Ndoshta kjo është një prej arsyeve pse sistemi ligjor në fuqi nuk është zbatuar ende plotësisht dhe pse nuk ka ndëshkim të plotë kur zyrtarët publikë shkelin rregullat e konfliktit të interesit. Përmirësime sociale dhe ligjore janë të domosdoshme dhe qeveria e re duhet t'i bëjë ato.

Gjermania: Modeli gjerman është shembulli më i mirë i një qasjeje të mirë juridike për trajtimin e problemit të konfliktit të interesave. Është e qartë se është e nevojshme të ketë një kuadër ligjor të së drejtës administrative shumë të zhvilluar dhe të sofistikuar për të paraqitur një qasje të tillë në një vend tjetër.

Italia: Italia është vendi me pikët më të larta të perceptimit të korrupsionit nga të gjitha vendet e zhvilluara. Ajo ka edhe një tipar tjetër karakteristik që është fakti se njeriu më i pasur në vend dhe pronari i kompanisë më të rëndësishme të komunikimit është zgjedhur si kryeministër. Së fundi, shumica e vendeve të punës në sektorin publik në Itali janë privatizuar dhe u nënshtrohen negociatave kolektive që në vitin 1993, megjithëse detyrat e punonjësve të sektorit publik ende përcaktohen nga punëdhënësi publik në përputhje me nenin 54 të Kushtetutës. Ky nen thekson se qytetarët e ngarkuar me funksione publike duhet t'i kryejnë ato me disiplinë dhe ndershmëri. Në çdo rast, marrëveshjet kolektive të punës janë përgjegjëse për përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore dhe ato nuk parashikojnë ndëshkime për konfliktin e interesit.

Spanja. Spanja ka bërë përpjekje serioze për të rregulluar konfliktin e interesave. Rregullorja spanjolle, me shumë pak përjashtime, vendos kufizime për zyrtarët publikë që të mos marrin pjesë në procese kontraktuese, etj. Nga ana tjetër, zyrtarët e lartë duhet të deklarojnë aktivitetin dhe interesat e tyre dhe ata duhet të plotësojnë edhe formularë të hollësishëm mbi të ardhurat dhe pasuritë e tyre, jo vetëm kur e marrin një detyrë, por edhe çdo vit dhe edhe kur largohen nga detyra në sektorin publik. Po ashtu, atyre iu kërkohet të bëjnë të njohura aktivitetet private që do të fillojnë kur të ndërpresin funksionet publike. Së fundi, ligji i ri i përmendur më sipër u kërkoi zyrtarëve të lartë të deklarojnë se ku kanë punuar më parë, përfshirë punën si konsulentë, ose nëse kanë qenë të përfshirë në ndonjë mënyrë. Kjo është e vlefshme edhe për bashkëshortët/bashkëshortet e tyre dhe për çdo person tjetër me të cilët ata kanë jetuar në një marrëdhënie personale analoge dhe për të afërmit jashtë familjes së vogël (p.sh. vëllezër e motra) gjatë dy viteve përpara

emërimet si zyrtarë të lartë. Megjithatë, zbatimi i ligjeve mbi konfliktin e interesave dhe papajtueshmërinë e funksioneve nuk ka qenë shumë i qëndrueshëm në Spanjë. Si pasojë, ndryshimet më të rëndësishme që duhet të bëhen kanë të bëjnë me zbatimin efikas të programeve të vjetra dhe të reja mbi konfliktin e interesave.

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME MBI POLITIKAT

1. Një strategji tërësore antikorrupsion: Megjithëse nuk është një praktikë e zakonshme në Shtetet Anëtare të BE të para vitit 2004, sipas përvojës së Gjermanisë, Hungarisë, Letonisë dhe Polonisë dhe Shteteve të tjera Anëtare të BE pas vitit 2004, duket se ka rezultuar e vlefshme përfshirja e politikave mbi konfliktin e interesave në një strategji të gjerë ose në një marrëveshje politike kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, që mbështetet në konsensusin politik. Kjo strategji duhet të përmbajë kuadrin strukturor, masat parandaluese, organet dhe procedurat e zbulimit dhe hetimit dhe sistemin e ndëshkimit. Politikat mbi konfliktin e interesave – si çdo politikë tjetër në sektorin publik – nuk mund të hartohen dhe të zbatohen me sukses nëse nuk ka një strategji efektive për krijimin e një koalicioni fitues me aktorët kryesorë⁷: Hartimi dhe zbatimi i një politike efektive mbi konfliktin e interesave është një punë e vështirë dhe me sfida, por në qoftë se një qeveri dëshiron të rrisë besimin e publikut tek institucionet demokratike dhe aktorët politikë dhe të ndërtojë një demokraci më të mirë dhe efikente, kjo punë nuk është vetëm e domosdoshme por edhe e pashmangshme.
2. Një numër standardesh të qarta etike në jetën publike: Për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, është e dobishme jo vetëm një strategji e gjerë, por edhe përcaktimi e vendosja e standardeve etike të qarta dhe të përbashkëta në jetën politike. Një kod etik bazë dhe gjithëpërfshirës duhet të udhëheqë veprimtarinë e zyrtarëve publikë. Qasja britanike është shembulli më i mirë për t'u ndjekur, megjithëse është e nevojshme të bëhet përshtatja e duhur e saj me qëllim që të jetë në përputhje me ligjet dhe konventat e vendit në fjalë.
3. Kuadër i mirë ligjor administrativ dhe penal: Është e nevojshme të hartohet një kuadër i mirë ligjor administrativ dhe penal brenda të cilit të zbatohen me efektivitet politikat e konfliktit të interesave.
4. Një shërbim civil profesional dhe një gjyqësor i pavarur: Megjithatë, që këto kuadro ligjore të japin rezultate duhet të shoqërohen me një shërbim civil profesional dhe një gjyqësor të pavarur. Modeli gjerman i të drejtës administrative dhe penale mund të jetë me interes, por edhe qasja franceze është gjithashtu shumë interesante në lidhje me shërbimin civil megjithëse mund të jetë më pak interesant në lidhje me politikanët.
5. Rregullim me kujdes i dorëheqjes dhe heqjes dorë nga vendimmarrja në sektorin publik: Një prej pikave më të rëndësishme të një programi të mirë mbi konfliktin e interesave është të ketë një rregullim të fortë mbi dorëheqjen. Kjo kërkon një listë të plotë e të hollësishme të shkaqeve që çojnë në dorëheqje apo heqje dorë. Qasjet frënge, gjermane dhe spanjolle mund të jenë shumë të dobishme për rregullimin e dorëheqjes.
6. Kufizim apo edhe ndalim për zyrtarët publikë të mbajnë detyra jashtë administratës: Kufizimet e forta mbi punësimin e njëkohshëm janë absolutisht të domosdoshme për anëtarët e qeverisë dhe zyrtarët publikë. Megjithatë, është po ashtu e këshillueshme të vendosen kufizime të tilla për gjyqtarët dhe nëpunësit civilë. Nëse parashikohen këto kufizime, nëpunësve civilë dhe gjyqtarëve duhet t'u jepet rrogë e mjaftueshme. Për më tepër, nëse të zgjedhurit lokalë marrin një rrogë në sektorin publik, ata duhet të jenë subjekt i kufizimeve që janë të ngjashme me ato për nëpunësit civilë dhe të emëruarit në poste politike. Modeli spanjoll mund të jetë i vlefshëm për të emëruarit në poste politike, modeli francez për nëpunësit publikë dhe modeli gjerman për gjyqësorin dhe modeli britanik për zyrtarët e zgjedhur lokalë. Asnjë zyrtar publik nuk duhet të lejohet të mbajë dy poste të paguara në sektorin

7 Pfeffer, Jeffrey (1992), *Managing with Power*, Harvard Business School Press, Boston, propozon hapat e mëposhtëm për përcaktimin e çdo strategjie. Megjithëse këto hapa janë propozuar në kuadër të sektorit privat, disa prej tyre mund të përshtaten për sektorin publik: 1) Përcakto se cilat janë qëllimet tuaja, se çfarë përpiqeni të arrini; 2) Diagnostiko modele të varësisë dhe ndërvarësisë; d.m.th. cilët individë apo grupe individësh kanë ndikim dhe janë të rëndësishëm për arritjen e qëllimeve tuaja?; 3) Cilat mund të jenë pikëpamjet e tyre? Si do të ndjehen ata për ato që po përpiqeni të arrini juve? ; 4) Cilat janë arsyeet e forcës, pushtetit dhe ndikimit të tyre? Çfarë mund të bëni për ta rritur më shumë ndikimin për të fituar më shumë kontroll mbi situatën?; 6) Duke marrë në konsideratë situatën me të cilën përballeni, cilat nga strategjitë dhe taktikat e ndryshme për ushtrimin e funksioneve duken më të përshtatshme dhe ka mundësi të jenë efektive?; 7) Mbështetur në pikat e mësipërme, zgjidhni një rrugë veprimi për të arritur qëllimet tuaja; 8) Së fundi, mos harroni të filloni të bëni vlerësimin që në fillim të procesit; është shumë e rëndësishme të nxirni mësimë përmes kryerjes së veprimeve dhe përmes bashkëveprimit.

publik, të angazhohet në ndonjë partneritet në biznes, ose të mbajë pozicionin e drejtorit të bordit të kompanisë private.

7. Deklarimi i të ardhurave: Deklarimi i të ardhurave nuk është domosdoshmërisht i nevojshëm nëse ka deklarim të pasurisë dhe deklarim të interesave, por do të ishte i vlefshëm për kontrollin e të emëruarve politikë dhe të zyrtarëve të zgjedhur vendorë. Është shumë e kushtueshme të detyrohet të gjithë nëpunësit civilë të deklarojnë të ardhurat dhe ndoshta do të ishte e mjaftueshme të detyrohen vetëm drejtuesit e lartë të deklarojnë të ardhurat. Qasjet spanjolle dhe portugeze mund të jenë të dobishme për rregullimin e deklarimeve të tilla.
8. Deklarimi i pasurisë: Deklarimi i pasurisë mund të jetë shumë i dobishëm për zbulimin dhe kontrollin e konfliktit të interesave të zyrtarëve të zgjedhur vendorë, deputetët e parlamentit dhe të emëruarit politikë. Megjithatë, mund të mos jetë i domosdoshëm dhe mund të jetë shumë i kushtueshëm detyrimi i të gjithë nëpunësve civilë për të deklaruar pasuritë. Mund të jetë e mjaftueshme që vetëm drejtuesit e lartë dhe nëpunësit civilë që bëjnë pjesë në kategori dhe sektorë në rrezik të deklarojnë pasuritë e tyre. Qasja hungareze – si edhe qasjet frënge, portugeze dhe spanjolle – mund të jetë e dobishme për rregullimin e kësaj çështjeje.
9. Deklarimi i të ardhurave familjare: Deklarimi i të ardhurave dhe pasurisë familjare është një masë që është shumë shtrënguese dhe ndoshta e vështirë për t'u mbështetur në Kushtetutë. Ndoshta, zgjidhja më e mirë është të vihet ky deklarim mbi baza vullnetare ose ai të jetë i detyrueshëm vetëm për zyrtarët e lartë publikë në qeveri dhe në institucione të tjera të larta.
10. Deklarimi i dhuratave: Është më mirë të vendosen kufizime të forta dhe të qarta për dhuratat dhe përfitimet sesa të bëhet i detyrueshëm deklarimi i tyre. Dhuratat mund të jenë hapi i parë drejt mitmarrjes, dhe si pasojë, ato duhet të ndalohen plotësisht, veçanërisht kur a) ato jepen si mirënjohje për një veprim të kryer nga zyrtari publik gjatë kryerjes së funksioneve të tij/saj, dhe as nuk kërkohen e as nuk inkurajohen; b) ato hedhin dyshime për pavarësinë dhe lirinë e zyrtarit publik për të vepruar; dhe c) ato nuk mund të deklarohen në mënyrë transparente para institucionit dhe qytetarëve. Dhuratat zyrtare për anëtarët e qeverisë dhe të emëruarit në poste politike duhet të bëhen pronë e trashëgimisë së shtetit. Dhuratat në shenjë mirësjelljeje (p.sh. kapëse, karfica apo stilografë) mund të pranohen vetëm nëse vlera monetare e tyre është shumë e vogël.
11. Përdorimi i informacionit të brendshëm: Përdorimi për qëllime private i informacionit të brendshëm duhet të dënohet si vepër penale, të paktën sa herë që sjell përfitime të tjera për zyrtarin publik apo familjen e tij/saj. Për të zbuluar këtë abuzim, mund të jetë e dobishme të ketë një regjistër kombëtar ose rajonal të zyrtarëve publikë në rrezik. Kontrolli periodik dhe i rastësishëm i pasurisë së këtyre zyrtarëve publikë mund të jetë i vlefshëm.
12. Deklarimi dhe regjistrimi i interesave personale: Deklarimi dhe regjistrimi i interesave personale përbëjnë një pikë tjetër të rëndësishme të një politike të mirë mbi konfliktin e interesave. Anëtarët e qeverisë, deputetët e parlamentit dhe të emëruarit të poste politike duhet t'i deklarojnë interesat tyre në një dokument zyrtar i cili rinovohet çdo herë që këto interesa ndryshojnë. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe nëpunësit civilë të kategorive dhe sektorëve në rrezik për konflikt interesi duhet gjithashtu të detyrohen të deklarojnë dhe regjistrojnë interesat e tyre. Modeli britanik është një shembull i mirë për t'u ndjekur.
13. Publikimi i deklaratave: Deklaratat e interesave dhe pasurive të zyrtarëve të zgjedhur dhe të të emëruarve në poste politike duhet të jenë të hapura për shqyrtim nga publiku, duke respektuar njëkohësisht rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së jetës private. Megjithatë, në rastin e nëpunësve civilë do të preferohej që deklaratat e tyre dhe publikimi i tyre të vihehin në dispozicion vetëm të drejtorit të institucionit përkatës ose organit përgjegjës për kontrollin dhe regjistrin. Modeli portugez dhe letonez janë interesantë, megjithëse kanë nevojë për përmirësime të caktuara në përputhje me kriteret e treguara më sipër.
14. Kufizime për punësimin pas largimit nga detyra: Kur kërkohet punë ose emërim pas largimit nga detyra publike, është e nevojshme të kufizohet dhe kontrollohet pozicioni i punës apo veprimtaria e OJQ, sepse zyrtarët publikë pritet të shmangin shfrytëzimin e detyrës publike ose të pozicionit publik

që kanë mbajtur më parë, përfshirë këtu informacionin e privilegjuar. Në këtë drejtim, qasjet britanike dhe franceze janë shumë interesante për nëpunësit civilë, dhe modelet spanjolle dhe portugeze për të emëruarit në poste politike.

15. Veprimtari jashtë institucionit duke qenë në funksionin publik: Emërimet jashtë institucionit, emërimet e njëkohshme në OJQ, sindikata ose parti politike – edhe nëse nuk paguhen – mund të hedhin dyshime mbi paanshmërinë e zyrtarëve publikë. Si pasojë, një punësim i tillë duhet të rregullohet dhe të mbahet në konsideratë në çdo politikë të mirë mbi konfliktin e interesave. Franca, Gjermania dhe veçanërisht MB kanë rregulla të forta që mund të nxisin një rregullim të arsyeshëm në këtë drejtim. Zakonisht, zyrtarët e zgjedhur dhe anëtarët e qeverisë janë anëtarë të partive politike dhe kjo është gjë e mirë dhe e pashmangshme në një demokraci, por duhet të bëhet një dallim ndërmjet politikës institucionale dhe politikës partiake në plotësimin e detyrave zyrtare.
16. Aksione në kompani private: Rasti italian na tregon rëndësinë e kufizimeve personale e familjare në mbajtjen e titujve të pronësisë në kompani private. Kompanitë private që janë nën kontrollin ose subjekt i vendimeve të një zyrtari publik nuk duhet të jenë në pronësi të këtij zyrtari publik. Zyrtarët publikë nuk duhet të zotërojnë kompani private që kanë kontrata ose janë bashkëpronare me sektorin publik. Në këto raste, interesat private mund të vinin në rrezik kryerjen e drejtë të funksioneve nga zyrtari publik. Pronësia e një përqindjeje të vogël të aksioneve në kompani të mëdha mund të pranohet kur ato janë pjesë e investimeve private dhe nuk kanë ndikim në politikat e këtyre kompanive. Kjo gjë duhet studiuar rast pas rasti në varësi të pozicionit të punës së zyrtarit publik. Heqja dorë nga pronësia, ose përmes shitjes ose përmes krijimit të një marrëveshjeje menaxhimi “qorre” është zgjidhja më e mirë kurdoherë që ka konflikt interesi me pronësinë e kompanisë. Modelet britanike, frënge, portugeze dhe spanjolle janë interesante.
17. Sistemi i zbulimit dhe hetimit, përfshirë një organ të specializuar të pavarur: Rregullimi i konfliktit të interesave në Evropë nuk ndryshon shumë nga vendi në vend, dhe disa vende kanë edhe rregullore shumë të ngjashme, por rezultatet nuk janë gjithmonë të njëjta. Arsytet e këtyre dallimeve i kanë rrënjët e tyre tek zbatimi i politikave. Për të zbatuar me efikasitet një politikë mbi konfliktin e interesave, është i nevojshëm një sistem i besueshëm zbulimi. Një ligj për bërjen publike do të ndihmonte shumë për zbulimin e shkeljeve të rregullave të konfliktit të interesave. Një ligj i tillë u jep mundësi njerëzve të raportojnë sjelljet e gabuara në sektorin publik kur ata kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se informacioni është i vërtetë. Po ashtu, ligji duhet të përcaktojë ndëshkime për ofrimin me qëllim të informacionit fals ose të shtrembëruar dhe duhet të sigurojë mbrojtje afatgjatë për sinjalizuesit e kësaj sjelljeje. Programet britanike dhe gjermane mund të jenë shumë të vlefshme për hartimin e një politike të tillë. Megjithatë, është shumë i nevojshëm një organ i pavarur përgjegjës për sistemin e zbulimit – një organ që ka stafin e mjaftueshëm dhe me kompetenca të mjaftueshme për të hetuar dhe ndjekur penalisht nëse është e nevojshme. Zyra në Letoni mund të shërbejë si një zgjidhje për analizën dhe përshtatjen me kulturën dhe ligjet e vendit. Zyra spanjolle për hetimin e antikorrupsionit mund të jetë gjithashtu një shembull frymëzues.
18. Përputhshmëria dhe komplementariteti i ndëshkimeve penale dhe administrative: Kur provohet se ka ndodhur një shkelje e ligjit, është i nevojshëm sistemi i ndëshkimeve pa përjashtim. Ndëshkimet penale dhe ndëshkimet disiplinore janë të domosdoshme. Modeli francez është një shembull i mirë për t’u analizuar, po ashtu janë edhe sistemet gjermane dhe polake. Për të zbatuar me sukses ndëshkimet penale është i nevojshëm sistemi i mirë i hetimit dhe i ndjekjes penale. Siç tregohet më sipër, Spanja ka një Zyrë të veçantë kundër korrupsionit në Prokurorinë Publike. Kjo Zyrë mbështetet me disa njësi të specializuara si edhe me prokurorë publikë të specializuar për krimin ekonomik dhe mashtrimin me tatimet në Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme. Ky model ia vlen të studiohet dhe ia vlen të bëhen përpjekje për të ngritur zyra të ngjashme. Po ashtu janë të domosdoshme edhe ndëshkimet disiplinore administrative. Modeli spanjoll i ndëshkimeve administrative për shkeljet e ligjit nga të emëruarit në poste politike është interesant, veçanërisht pengimi i emërimit në një post publik deri në dhjetë vjet pas kësaj shkeljeje. Megjithatë, ndëshkimet disiplinore administrative kanë nevojë për një sistem të mirë hetimi dhe procedimi, dhe kjo është arsyeja pse duhet të trajnohen inspektorët e brendshëm për këto çështje si pjesë të një programi të koordinuar. Ndonjëherë disa ndëshkime kundër “të mëdhenjve” mund të kenë efektin afatgjatë të të vepruarit të shumicës në përputhje me ligjin.

SHTOJCA 1

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
Pjesë e një politike më të gjerë?	Po, politikë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit	Po, politikë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit	Po, pjesë e rregulloreve kundër korrupsionit	Po (pjesë e standardeve etike në sektorin publik)	Jo.	Jo	Po, ka një politikë më të gjerë kundër korrupsionit që në vitin 1995.	Po	Jo
Qasje parandaluese?	Parandaluese dhe kuruese	Parandaluese dhe kuruese	Parandaluese dhe kuruese	Po, me këshilla në raste të caktuara	Parandaluese	Parandaluese dhe kuruese	Kryesisht parandaluese	Po	Parandaluese
<u>Masa parandaluese</u> 1. Kufizime mbi punësimin shtesë. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë. 2. Deklarimi i të ardhurave personale.	1.a Po, disa 1.b Po, disa 1.c Po 1.d dhe e NA 2.a Po 2.b Po	1.a Po, shumë strikt 1.b Po 1.c Po 1.d Po, por i pajtueshëm me punësimin privat. 1.e Po 2. a Po	1.a Po 1.b Po, rregulla të ndryshme. 1.c Po 1.d Po, por i pajtueshëm me punësimin privat. 1.e Po, por i pajtueshëm me deputet në Parlament. 2. d Po	1.a Po 1.b Po 1.c Po 1.d Mund të ushtrojnë disa të tjera të caktuara 1.e Mund të ushtrojnë disa të tjera të caktuara 2.d Po, nëse është më	1.a Po. 1.b Po, disa 1.c Po 1.d Po, disa 1.e Po, disa.	1.a Po 1.b Po, shumë strikt 1.c Po 1.d Po, por i pajtueshëm me punësimin privat. 1.e Po, por i pajtueshëm me deputet në Parlament	1.a Po, shumë strikt 1.b Po 1.c Po 1.d Mund të ushtrojnë disa të tjera të caktuara 1.e Mund të ushtrojnë disa të tjera të caktuara 2.d Po (pagesa më të	1.a Po 1.b Po 1.c Po 1.d Mund të ushtrojnë disa të tjera të caktuara 2.a, d, e Po	1.a Po, shumë strikt. 1.b Po 1.c Po 1.d Po, shumë strikt 1.e Po, nëse zgjedhin një punë me kohë të plotë. 2.a Po, çdo vit. 2.b Jo

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.	2.d Po 2.e Po	2. e Po		shumë se 1% e rrogës	burimet e të ardhurave që tre muaj përpara) 2 d Po		larta se 10.000 euro duhet të deklarohen).		2.c Jo 2.d Po (ata deklarojnë vetëm veprimtaritë e paguara) 2.e Po, përpara punësimit.
3. Deklarimi i të ardhurave familjare. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.	3. Jo	3. a dhe e Po (bashkëshortët)	3. Jo	3.a,b,c,d,e: Jo	3. a Po (aktivitete sipërmarrjeje)	3. Jo	3. Jo	3. Jo	3.a Vullnetarisht (bashkëshortët)
4. Deklarimi i pasurisë personale. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë	4.a Po 4.b Po 4.d.Po 4.e Po	4.a Po 4.b Po 4.c Po 4.d. Po 4.e Po	4.a Po 4.b Po, drejtuesit e lartë. 4.d Po	4.a,b,c,e: Jo 4.d: Po nëse vlen më shumë se 59.000 Pounds	4. a Po (përpara punësimit, asetet e sipërmarrjes) 4. d Po	4.a Po, përfshirë kompanitë publike. 4. b Jo. 4.d Po 4.e Vetëm disa	4.b Është e nevojshme vetëm një deklaratë nga kandidatët për shërbimin civil, që	4.a, d, e Po	4.a Po 4.b Jo 4.c Jo 4.d Po 4.e Po

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.						prej tyre	pranojnë se nuk kanë borxhe të mëdha.		
5. Deklarimi i pasurisë familjare. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.	5. Jo	5. a dhe e Po (bashkëshortët).	5. a Po, familja që banon me të emëruarin. 5. b Po, vetëm pjesëtarët e familjes që janë drejtues të lartë.	5. Jo	5.a Po (asetet e sipërmarrjes).	5. Jo	5. Jo	5. Jo	5.a Vetëm vullnetarisht (bashkëshortët).
6. Deklarimi i dhuratave. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit	6.a Po 6.b Po 6.d Po 6.e Po	6.a dhe e Po	6.d Po	6.a Po 6.d Po, nëse ka një vlerë më të lartë 1% e rrogës	6 Jo	6. d Po	6.a Po 6.d Po, nëse ka një vlerë më të lartë se 5000 Euros.	6. NA	6.a Po

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<p>Fakte\vende vendorë.</p> <p>7. Siguria dhe kontrolli në marrjen e informacionit të brendshëm. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p> <p>8. Deklarimi i interesave private në lidhje me menaxhimin e kontratave. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Të zgjedhurit lokalë</p>	<p>7.NA</p> <p>8. Jo</p>	<p>7. b Po, por vetëm për informacionin konfidencial, nuk ka kufizime për përdorimin e informacionit zyrtar për përfitime personale .</p> <p>8. Jo</p>	<p>7. b dhe d Po</p> <p>8. Jo</p>	<p>7.a Po.</p> <p>8.a Po 8.b Po 8.c Po (përfshin interesat e familjes dhe të personave të ngushtë)</p>	<p>7 NA</p> <p>8. a. Përpara punësimit, interesat sipërmarrëse dhe private.</p>	<p>7. b Po</p> <p>8. Jo</p>	<p>7 NA</p> <p>8. c Po</p>	<p>7. NA</p> <p>8.a Po (për tre vjet para) 8.c Jo e detyrueshme</p>	<p>7.a Po 7.b Po 7.c Po 7.d Po</p> <p>8.a Po (për dy vjet para). 8.c Po</p>

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<p>9. Deklarimi I interesave private në lidhje me vendimmarrjen ose votimin.</p> <p>a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë</p> <p>b. Nëpunësit civilë.</p> <p>c. Gjyqësori</p> <p>d. Parlamentet</p> <p>e. Të zgjedhurit vendorë.</p>	9. Jo	9. Jo	9. d Po	<p>9. a Po</p> <p>9.b Po</p> <p>9.c Jo</p> <p>9.d Po</p> <p>9.e Po</p> <p>(përfshin interesat e familjes dhe të personave të ngushtë)</p>	9. a Përpara punësimit, interesat sipërmarrëse dhe private.	9. Jo	<p>9. d. Po</p> <p>9. e Po</p>	<p>9.a Po (për tre vite para)</p> <p>9.d Po</p> <p>9.e Jo e detyrueshme</p>	<p>9.a Po (për dy vjet para).</p> <p>9.d dhe e Po.</p>
<p>10. Deklarimi i interesave private në lidhje me pjesëmarrjen në përgatitjen ose dhënien e këshillave për politikën.</p> <p>a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë</p> <p>b. Nëpunësit civilë.</p>	10. Jo	10. Jo	10. Jo	<p>10.a Po</p> <p>10.b Po</p> <p>10.c Po</p> <p>(përfshin interesat e familjes dhe të personave të ngushtë)</p>	10.a Përpara punësimit, interesat sipërmarrëse dhe private.	10. Jo	10. c Po	10.a Po	<p>10.a Po (për dy vjet para).</p> <p>10. c Po.</p>

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<p>c. Të zgjedhurit vendorë</p> <p>11. Bërja publike e deklaratave të interesave, të të ardhurave dhe të aseteve.</p> <p>a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë</p> <p>b. Nëpunësit civilë.</p> <p>c. Gjyqësori</p> <p>d. Parlamentet</p> <p>e. Të zgjedhurit vendorë.</p>	<p>11. Po</p>	<p>11. Po, por vetëm e</p>	<p>11. Jo</p>	<p>11.a Po për dhuratat.</p> <p>11.d Po, për interesat</p>	<p>11. d Po</p>	<p>11. Jo</p>	<p>11. d Po</p>	<p>11.a, d, e Po për të ardhurat dhe interesat</p>	<p>11. a Po, vetëm anëtarët e qeverisë dhe sekretarët e shtetit .</p> <p>11. d dhe e Po, por vetëm me kërkesë.</p>
<p>12. Kufizime dhe kontrolli i punësimit ose i aktivitetit me OJQ pas largimit nga detyra publike.</p> <p>a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë</p> <p>b. Nëpunësit</p>	<p>12. NA</p>	<p>12. a (duhet të marrë pëlqimin)</p> <p>12. b dhe e (një vit pas largimit).</p>	<p>12. Jo</p>	<p>12.b Po, për dy vjet dhe ata duhet të raportojnë qasjet</p>	<p>12. b Po (disa)</p>	<p>12. a Po</p> <p>12. b Po (5 vjet).</p> <p>12. d Shumë pak (institucionet e kursimit ose kompanitë e subvencionuara nga shteti)</p> <p>12. e Po</p>	<p>12. Jo</p>	<p>12.a Po për tre vjet</p>	<p>12.a Po (për dy vjet).</p>

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<p>civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p> <p>13. Kufizime dhe kontrolli i dhuratave dhe formave të tjera të përfitimeve. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p> <p>14. Kufizime dhe kontrolli i emërimeve të njëkohshme (p.sh. OJF ose parti politike). a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit</p>	<p>13. NA</p> <p>14.a dhe c PO</p>	<p>13. a dhe e Po.</p> <p>14. a, b, c Po</p>	<p>13. d Po</p> <p>14. b Po. Nuk lejohen të jenë në pozicione të larta në parti politike 14. c Po</p>	<p>13.a Vetëm vlera nën 140 Pounds mund të mbahet. 13.b Po 13. d Po, kur vlera është më e lartë se 125 pounds duhet të bëhet e njohur.</p> <p>14.a Po 14.b Po 14.c Po 14.d Po 14.e Po</p>	<p>13. Jo</p> <p>14. c Po</p>	<p>13. Jo kontroll, por kufizime po, kur prek pavarësinë.</p> <p>14. Po, kur OJQ janë nën kontrollin e zyrtarit publik. 14. c Po</p>	<p>13. a dhe b Po</p> <p>14. a Po. Ligji i ndalon emërimet në poste honorifike.</p>	<p>13. NA</p> <p>14. NA</p>	<p>13.a, b, c, d, dhe e Po.</p> <p>14.a Po 14. b Vetëm nëpunësit e shërbimit civil si ushtarakë. 14. c Po 14. e Po (OJQ).</p>

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<p>politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p> <p>15. Dorëheqja (tërheqja rutinë) a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p>	15. Po	15. a, b, c, e Po	15. NA	15.a,b,c,e Po	15. a, b, c, e Po	15. a, b, c, e Po	15. a Po 15. b Po 15. c Po 15. e Po	15. a, b, c, e Po	15. a Po 15. b Po 15. c Po 15. e Po
<p>16. Kufizime personale dhe familjare mbi titujt e pronësisë në kompani private. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit</p>	16.a Po 16.b Po 16 d Po 16.e Po	16. a dhe b (jo më shumë se 10% të aksioneve në një kompani të themeluar sipas	16. b Po. Asnjë problem me titujt e pronësisë, vetëm papajtueshmëri me pozicione drejtuese dhe anëtarësi në	16.a,b,c,d,e: Po	16. d dhe e Po, Po, kur atyre iu kontrollohen vendimet.	16.a, b, c dhe e Po, kur atyre iu kontrollohen vendimet.	16. Jo	16. a, b, c, d, e, Po	16. a, b, c, d, e, Po

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<p>politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p> <p>17. Zhveshja nga pronësia ose përmes shitjes, ose përmes arritjes së një marrëveshjeje menaxhimi besimi apo qorre. a. Të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë.</p>	17. Jo	<p>të drejtës tregtare). 16. e nuk lejohen të kenë në pronësi biznes privat.</p> <p>17. a, b dhe e mund të jetë e domosdoshme pas deklarimit të interesave private.</p>	borde. 17. Jo	17.a Po	17. e Zhveshja nga pronësia mund të jetë një zgjidhje për konfliktin e interesave për të zgjedhurit lokalë, por jo për qeverisjen qendrore. Besimi i errët	17. Po	17. Jo	17. NA	17.a Po

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<u>Zbulimi</u> 1.Mbrojtje me rënie sinjali? 2. Organ i pavarur?	1. Jo 2. (CPCB) Zyra e Parandalimit dhe Luftës kundër Korrupsionit (ajo gëzon një shkallë të caktuar pavarësie).	1. Jo 2. Jo organ i pavarur. Zbulimi përmes hierarkisë (mbikëqyrja nga kryeministri dhe ministrat në qeverisjen qendrore; guvernatorët dhe Bordi i apelimit të Vetëqeverisjes në pushtetin vendor). Gjithashtu Dhoma e Lartë e Kontrollit dhe Avokati i Popullit ndihmojnë në zbulimin. Thesari i Shtetit kontrollon pushtetin vendor.	1. Po. 2. Jo organ i pavarur. Zbulimi përmes hierarkisë.	1. Po 2. Komisioni i Standardeve në Jetën Publike; Komisioneri parlamentar për standardet; dhe Bordi i Standardeve të Anglisë (me zyrat lokale) për pushtetin vendor	1. Jo 2. Autoriteti Italian i Konkurrencës dhe Autoriteti Italian i Komunikimit vetëm për anëtarët e qeverisë. Nëpunësit civilë dhe gjyqësori: përmes hierarkisë. Parlamenti: Kryetarët e Dhomave. Gjithashtu, Komisioneri i Lartë për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe formave të tjera të veprave në administratën publike.	1. Jo 2. Komisioni për Transparencën e Financimit Politik (PFTC) (jo i pavarur) kontrollon deklarimin e pasurive. Tre komisione të etikës profesionale kontrollojnë punësimin pas largimit nga detyra publike.	1. Po 2. Jo. Zbulimi përmes hierarkisë.	1. NA 2.Gjykata Kushtetuese	1. Jo 2. Për të emëruarit në qeveri dhe të emëruarit politikë: Zyra e konfliktit të interesave (gëzon njëfarë pavarësie). Nëpunësit civilë dhe gjyqësori: përmes hierarkisë. Deputetët e Parlamentit: Kryetarët e Dhomave. Të zgjedhurit vendorë: përmes ankesave.

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
<u>Hetimi</u> 1. Kush? 2. Llogaritë bankare 3. Të dhënat nga zyra e taksave	1. CPCB 2 dhe 3 Po	1. Prokurorët publikë nëse është krim. Po ashtu, policia dhe Agjencia për Sigurinë e Brendshme. Nëse jo, hierarkia (kryeministër dhe ministrat në pushtetin qendror; kryetarët e bashkive dhe Bordi i vetëqeverisjes i Apelit në pushtetin vendor). Thesari i Shtetit heton deklarin e zyrtarëve të pushtetit vendor.	1. Regjistri i Deklarimit të Pasurive dhe Zyra e Kontrollit (ADRCSB). 2 dhe 3. Po.	1. Komisioneri i parlamentit për standardet dhe Bordi i Standardeve (qeverisje lokale) 2 dhe 3. Vetëm në hetim penal	1. Autoriteti Italian i Konkurrencës dhe Autoriteti Italian i Komunikimit. Në rastet penale prokurorët publikë. 2 dhe 3 Po por është i nevojshëm urdhri i gjyqtarit.	1. Gjyqtarët (penal), Komisioni kundër Pastrimit të Parave (TRACFIN) dhe PFTC 2 dhe 3 vetëm gjyqtarët mund të vendosin.	1. Prokurorë publikë nëse është krim. Inspektorët e tatimeve nëse ka mashtrim me taksat. 2 dhe 3 Vetëm gjyqtarët. Inspektorët e tatimeve gjithashtu mund të kontrollojnë të dhënat mbi llogaritë bankare.	1. Gjykata Kushtetuese, dhe pushteti gjyqësor (Drejtoria Qendrore për Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar dhe Korrupsionit). 2 dhe 3 vetëm në hetim penal	1. Të emëruarit e qeverisë dhe politikë: Zyra e Konfliktit të Interesave. Zyra mund të hetojë të dhënat tatimore. Nëpunësit civilë dhe gjyqësori: Inspektorët e brendshëm. Kur janë krime: prokurorët publikë (Zyra Speciale e Prokurorisë kundër Korrupsionit). 3. Vetëm gjyqtarët.
<u>Procedimi</u> Gjyqësor ose administrativ	CPCB: Gjykata administrative: Prokurorë publikë	Gjyqësor; prokurorë publikë. Administrativ: Eprorët dhe organi	ADRCSB: Procedim administrativ. Gjyqësor vetëm nëse ka dhënie	Të dyja	Gjyqësor: kur ka korrupsion. Administrativ: përmes hierarkisë.	Vetëm gjyqtarët: Penal. Administrativ: Inspektorët e shërbimit civil	Vetëm gjyqtarët: penal. Administrativ: Inspektorët e shërbimit civil	Vetëm gjyqtarët: penal. Administrativ: Inspektorët e shërbimit civil	Penal: vetëm gjyqtarët. Administrativ: Inspektorët dhe Zyra e Konfliktit të

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
		mbikëqyrës.	ryshfeti.						Interesave.
<u>Ndëshkime</u> 1. Penale 2. Disiplinore 2.1 Pezullimi i rrogës a. Të emëruarit në qeveri dhe politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë. 2.2 Pushimi a. Të emëruarit politikë b. Nëpunësit civil. c. Gjyqësori d. Parlamentet e. Të zgjedhurit vendorë. 3. Administrative a. Të emëruarit politikë b. Nëpunësit civilë. c. Gjyqësori d. Parlamentet	1. Po, deri në 5 vjet burgim nëse shkaktohet dëm themelor. 2.1 b, c Po 2.2 a,b,c,d,e Po 3. Po, gjoba dhe sanksione morale.	1. Penal: Po. Zyrtarët publikë lokalë deri në tre vjet burgim për deklaram fals. 2.1. b dhe e Po 2.2. a, b, c dhe e Po	1. Jo. 2. 2 a, b.	1. Penal: Po për të zgjedhurit politikë dhe anëtarët e parlamenteve rajonale kur nuk japin dorëheqjen kur duhet dhe për mosdeklarimin e interesave financiare (periudhë transitore) 2. Disiplinore: 2.1.b Po 2.1.d Po 2.2.b Po	1. Vetëm për krimin e korrupsionit. Por është e mundshme edhe kur anëtarët e qeverisë nuk e dorëzojnë deklaramin e interesave pse e dorëzojnë atë me informacion fall, pas kërkesës nga autoriteti përgjegjës. 2. 1 b dhe c Po 2.2. b dhe c Po 3. Raport tek Kryetarët e Dhomave të Parlamentit është parashikuar	1. Po, deri në pesë vjet burgim dhe gjobë prej 75.000 Euro për kërkim të jashtëligjshëm të interesit. 2. Disiplinore, 2.1 b dhe c Po 2.2 a, b dhe c Po 3. a, b, c dhe e Punësim shtesë i jashtëligjshëm, gjoba deri në 1500 Euro.	1. Penal: vetëm kur ka qëllim penal. Krime: pranimi i avantazhit (të tillë si para ose bizhuteri), Shtrembërim i drejtësisë dhe mitmarrje. 2.1. b Po 2.1 c Po 2.2. b Po 2.2. c Po 3. Shkeljet e rregullave mbi konfliktin e interesave nga deputetë të parlamentit: botimi në Gazetën	2.2.a, b dhe c Po 3.a Ndalimi i mbajtjes së detyrës publike për tre vjet.	1. Penal: Vetëm kur është krim (d.m.th. ryshfet). 2. Disiplinore 2.1.b Po 2.1.c Po 2.2.a. Po 2.2.b Po 2.2.c Po 3. Të emëruarit në qeveri dhe politikë: shkelje e ligjit nënkupton botimin në "Buletinin Zyrtar të

Fakte\vende	LETONI	POLONI	HUNGARI	MB	ITALI	FRANCË	GJERMANI	PORTUGALI	SPANJË
e. Të zgjedhurit vendorë.					për shkeljet e ligjit nga anëtarët e qeverisë.		Zyrtare të Parlamentit.		Shtetit". Kur ka vepra të rënda: Ndalimi për emërim në një pozicion publik për deri në 10 vjet. Kthimi i parave të marra në mënyrë të paligjshme.